




Çmimi 4 lekë

NËNTORI

pesë copë

NËNTORI 4

E PERMUAJSHME LETRARE ARTISTIKE SHOQËRORE POLITIKE



NENTORI

Revistë e përmuajshme
letrare artistike
shoqërore politike

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE
TË SHQIPËRISË

Nr. 4

VITI XXII I BOTIMIT

PRILL, 1975

LËNDA:

	Faqe	
Për një hop të ri cilësor të le- tërsisë dhe të arteve tona.	3	
Mbledhje e plenumit të Komi- tetit Drejtues të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.	3	
Raporti i shokut Dritëro Agolli.	7	
Nga diskutimet në plenum.	34	
Vlerësim dhe inkurajim i madh.	56	
Krijime letrare		
MARO PASHO	C'më tha këngëtarja popullore nga Piluri — Veterani — Tra- ditë — Majave, <i>vjersha</i>	59
SPIRO SOTA	Dhentë shtegtojnë drejt bjesh- këve — Janë rritur pishat e tua, Resmi, <i>vjersha</i>	62
ALEKSANDËR ZAKA	Pranverë në Myzeqe, <i>vjershë</i> ..	64
FERIT RAMA	Kangjelat arbëreshe, <i>vjershë</i>	65
SKËNDER S. RUSI	E zakonshme, <i>vjershë</i>	66
FATMIR MUSAI	Elegji për kovaçin Braho — Vaji i nënës, <i>vjersha</i>	67
VLADIMIR TOROVECI	Luftëtarit kombëtar — 5 Maj, <i>vjersha</i>	69
30-vjetori i Forcave të Kufirit		
THOMA FRASHËRI	Ngujimi, <i>tregim</i>	73
Kritika letrare artistike		
FATOS ARAPI	Zëra të rinj poetikë	84
KRISTAQ DHAMO	Arritje dhe detyra të kinema- tografisë sonë	101

	Faqe
ALI XHIKU	Probleme të krijimtarisë së No- lit 110
Fjala e lexuesit dhe spektatorit	
PETRO DUDI — FEJZI MURATI	Kënga e birit për nënën 119
THOMA NIKA	Nëpër udhët e lavdisë 125
BUJAR SKËNDO	Dy tregime që vënë në qendër heroin pozitiv 127
KOLË JAKOVA	Naimi, aktor i madh militant. 132
Tradita të letërsisë	
JERONIM DE RADA	Nga fillimet e jetës dhe të kri- jimtarisë 142
Letërsi e huaj	
O. BALZAK	Kryevepra e panjohur 153
Recensione, letërsi-art	
MIHO GJINI	«Familja e peshkatarit» një sukses i spektaklit televiziv 181
FAIK BALLANCA	E vërteta lakuriqe për një botë të përmbysur 185
NAUM PRIFTI	Lirizmi dhe këndi i vështrimit të autorit 187
Kronika	
● Mbrëmje përkujtimore me rastin e 50-vjetorit të vdekjes së shkrimtarit dhe patriotit Luigj Gurakuqi. ● Jeta e popullit — burim frymëzimesh të reja 191	

Në kopertinën I: «Kufitarët» nga Pandi Mele.

Në kopertinën IV: «Në kufi», foto nga Rexhep Zharra

Në këtë numër botojmë skica dhe fotografi kushtuar 30-vjetorit të
Forcave të Kufirit dhe të Policisë Popullore.

Kolegjumi i redaksisë

PER NJE HOP TE RI CILESOR TE LETERSISE DHE TE ARTEVE TONA

Mbledhje e Plenumit të Komitetit drejtues të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë

Në atmosferën e shëndoshë dhe frymën e lartë revolucionare, që ka ngjallur fjala e shokut Enver Hoxha e 20 dhjetorit 1974, më 27 dhe 28 shkurt u mbledh plenumi i Komitetit drejtues të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Në plenum merrnin pjesë anëtarët e tij, kryetarë të degëve të Lidhjes në rrethe, kryetarë të grupeve të shkrimtarëve dhe artistëve të Tiranës, rapsodë e këngëtarë të shquar, drejtues të institucioneve kulturore e artistike, përfaqësues të shtypit etj.

Merrnin pjesë gjithashtu anëtari i Byrosë së Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të Partisë Ramiz Alia, ministri i Arsimit e i kulturës Thoma Deliana e shokë të tjerë.

Kryetari i Lidhjes së shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë Dritëro Agolli mbajti referatin «Për një hop të ri cilësor të letërsisë e të arteve në dritën e fjalimit të kohëve të

fundit të shokut Enver, mbajtur në Sekretariat-in e Komitetit Qendror të Partisë». U mbajt gjithashtu referati «Drejtimit kryesore të punës ideestetike dhe krijuese të shkrimtarëve dhe artistëve» nga sekretari i përgjithshëm i Lidhjes Xhemal Dini, që foli për rëndësinë historike të fjalës së shokut Enver, për frymëzimin që ajo ka ngjallur te shkrimtarët dhe artistët tanë, për të shpënë përpara letërsinë dhe artet me vepra të denja dhe për të marrë pjesë gjallërisht në aktivitetet shoqërore. Më poshtë, ai tha: «Vetëm me veprimtari e punë të gjallë, intensive, të vazhdueshme, me mënyra e forma të shumta, organizata jonë mund të bëhet një qendër e vërtetë frymëzimi, që të ndihmojë konkretisht shkrimtarët e artistët për të krijuar vepra me përmbajtje të shëndoshë e formë të lartë artistike». Ai theksoi se fjalimi programatik i shokut Enver dhe atmosfera revolucionare e optimiste që zotëron në radhët e krijuesve, vënë organizatën e Lidhjes, forumet drejtuese, aparatit dhe shtypin e saj letrar para detyrash të mëdha. Për të realizuar këto detyra, vazhdoi shoku Xhemal Dini, veprimtaria e Lidhjes duhet përqëndruar në zhvillimin e mëtejshëm të mendimit teoriko-filozofik e profesional për letërsinë e artet, duke ndihmuar kështu në brumosjen më të thellë ideologjike marksiste-leniniste të krijuesve, në rritjen e vlerave cilësore të krijimtarisë së tyre. Lidhja dhe degët e saj, përmes diskutimeve e rrahjes së mendimeve midis krijuesve dhe midis tyre e popullit, duhet të përgjithësojnë përvojën tonë krijuese, traditat më të mira të së kaluarës sonë e sidomos traditën e letërsisë dhe artit të realizmit socialist. Gjithashtu të zgjerojnë më tej e të ngrenë më lart nivelin e punës për edukimin ideopolitik të krijuesve, duke thelluar përvojën e fituar pas Plenumit IV të KQ të PPSH, të intensifikojnë veprimtarinë në ata sektorë, lloje e gjini të letërsisë e artit, që janë relativisht më pas, dhe të forcojnë vazhdimisht ndihmën që u japin talentëve të reja». Ai u ndal në masat konkrete, që duhet të marrë Lidhja dhe degët e saj nëpër rre-

the për të realizuar detyrat aktuale, që shtrën Partia para letërsisë e arteve, që shkrimtarët dhe artistët të kryejnë sa më mirë misionin, që u ka besuar Partia si ndihmës të saj për edukimin komunist të masave.

Në plenum diskutuan mjaft shokë. Pjesë nga disa diskutime po i botojmë në këtë numër.

O. Paskali, T. Daija, B. Kozeli, S. Kamberi, D. Zyko dhe këngëtarja e re A. Hisku etj., që e muarën fjalën në këtë plenum, u shprehën për thellimin e njohjes së jetës së popullit e për pasqyrimin e saj me partishmëri të lartë, si dhe për përvetësimin e artit popullor dhe traditës së realizmit socialist dhe të asaj përparimtare të së kaluarës sonë e për probleme të tjera.

Skulptori Odhise Paskali theksoi, midis të tjerash, se traditat e popullit tonë janë të lashta dhe ato dëshmojnë për një rezistencë e forcë vitale të jashtëzakonshme. Roli i letërsisë dhe i arteve është shumë i rëndësishëm për pasqyrimin e jetës së tij. Kompozitori Tish Daija theksoi nevojën për t'u lidhur fort me krijimtarinë e popullit, ta njohim atë duke bërë një studim dhe thellim të mëtejshëm në këngën dhe vallen popullore. Piktori S. Kamberi ngriti problemin e përhapjes akoma më të madhe të veprave të arteve figurative në masat punonjëse, që t'i edukojnë e t'i frymëzojnë në punën e tyre të përditshme, duke përmbushur qëllimin e tyre të lartë. Ndërsa shoku B. Kozeli, pasi foli për atmosferën e zjarrit, që ka krijuar fjala e shokut Enver në shkrimtarët dhe artistët e Vlorës, u ndal në masat, që ka marrë dega e Lidhjes së këtij rrethi për nxitjen e krijimtarisë, si aksionet konkrete dhe iniciativat për të shkruar në qendra prodhimi e kooperativa bujqësore etj. Ai theksoi se në diskutimet e veprave është e nevojshme pjesëmarrja e gjerë e krijuesve, por dhe e njerëzve të punës e prodhimit, që e duan aq shumë letërsinë dhe artin. Diskutimet të bëhen jo vetëm në Tiranë, por në gjithë rrethet e vendit tonë. Shoku A. Kristo foli për probleme të botimit të ve-

prave letrare. Këngëtari popullor Demir Zyko shprehu entuziazmin, që buron nga fjala e shokut Enver e 20 dhjetorit 1974, për gjithë popullin dhe krijuesit, edhe për këngëtarët popullorë. «Kam 45 vjet që ia marr këngës, tha ai, po kush pyeste në të kaluarën në këndoja unë apo jo». Ai falenderoi Partinë dhe shokun Enver për kujdesin e madh me të cilin rrethojnë talentet, që dalin nga gjiri i popullit. Edhe këngëtarja A. Hisku, e frymëzuar nga fjala e shokut Enver, tha: «Ashtu siç do të punoj me vrull e pa u kursyer për të realizuar e tejkaluar detyrat e planit të vitit 1975 si punëtore e Stabilimentit «Mihal Duri», ashtu do përpiqem të arrij rezultate të larta edhe në skenë e në çdo aktivitet kulturor e artistik».

Në fund, e mori fjalën shoku Dritëro Agolli, i cili bëri konkluzionet e mbledhjes.

Si raportet ashtu edhe diskutimet, që u mbajtën në këtë plenum, në dritën e fjalës së shokut Enver, ishin shumë të dobishme dhe ndihmuan të shoshiten problemet, që dalin para nesh në stadin e sotëm të zhvillimit të letërsisë dhe arteve. Fjala e shokut Enver, mbajtur në Sekretariat të KQ të PPSH më 20 dhjetor 1974, është një burim mendimesh e frymëzimi për të zbuluar dhe zgjidhur problemet, që preokupojnë sot letërsinë dhe artet. Plenumi theksoi me forcë drejtësinë e parimeve udhëheqëse të Partisë, domosdoshmërinë e njohjes më të thellë dhe të vazhdueshme të jetës, të përvetësimit të botëkuptimit marksist-leninist dhe të zhvillimit të harmonishëm të të gjitha gjinive dhe llojeve të artit tonë. Plenumi ishte një nxitje e rëndësishme për t'i trajtuar më thellë problemet për të zbatuar më mirë në praktikë vijën e Partisë në fushën e krijimtarisë letrare artistike. Plenumi tërhoqi vëmendjen për kuptimin dhe zgjidhjen e drejtë të një varg detyrash, që do të shpien më përpara krijimtarinë dhe punën e organizatës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

RAPORTI I SHOKUT DRITËRO AGOLLI

Shkrimtarët dhe artistët, sa më shumë që kalon koha nga botimi i fjalës së shokut Enver Hoxha, mbajtur në Sekretariat të KQ të Partisë më 20 Dhjetor të 1974-ës, aq më tepër bien në mendime, të preokupuar thellë për mbarëvajtjen e letërsisë dhe arteve. Në preokupimin e tyre ndjehet hapur përgjegjësia e vetëdijshme prej artisti dhe qytetari për të kryer atë mision të lartë fisnik dhe revolucionar që u ka ngarkuar populli në stadin e sotëm të zhvillimit të shoqërisë sonë. Ky preokupim nuk është vetëm i shkrimtarëve dhe artistëve, por i mbarë shoqërisë, pasi letërsia dhe arti po bëhen përherë e më shumë çështje e të gjithëve, e të vegjëlve dhe e të mëdhenjve. Prandaj, kur del ndonjë dokument i rëndësishëm i Partisë për problemet e krijimtarisë, bashkë me krijuesit interesohen dhe mendohen të gjithë; dhe kjo bëhet një forcë e madhe frymëzuese për vepra të reja.

Në dokumentin e ri të Partisë, në fjalën e shokut Enver, ngrihen probleme teorike e praktike, siç janë ato të formimit të botëkuptimit të ri dhe koncepteve të reja për krijimtarinë, të njohjes së jetës dhe të kontradiktave të brendshme dhe të jashtme, të zhvillimit të gjinive të letërsisë dhe të artit, të raportit të artit popullor dhe të kultivuar e të tjera. Fjala e shokut Enver është ngritur mbi bazat e filozofisë marksiste-leniniste, duke u mbështetur fort në truallin tonë. Ajo shënon një përparim të mëtejshëm të mendimit tonë estetik, që ka lindur nga eksperiencia shumëvjeçare e Partisë sonë. Idetë, që ngrihen në këtë fjalim programatik, mënyra se si ato trajtohen janë një ndihmë e madhe për krijuesit, për formimin dhe edukimin e krijuesve me koncepte të qarta për krijimtarinë, për botëkuptimin dhe talentin. Ato duhen studjuar e trajtuar në prizmin filozofik e teorik, se kështu do të zhvillojmë më tej estetikën tonë revolucionare.

Duke u thelluar në tërë këto probleme, para nesh hapen horizonte të gjera krijimi dhe, njëkohësisht, dalin detyra të mëdha për sot e për të ardhmen, zbatimi i të

cilave është vënia në jetë e vendimeve të Plenumit të 4-t të KQ të Partisë dhe i programit të Kongresit të saj të 6-të.

Në plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, që po mbajmë sot, ne do të ndalemi në disa nga problemet më të mpërhta, që shqetësojnë letërsinë dhe artin dhe do të diskutojmë gjerësisht në mënyrë që të ndihmojmë zhvillimin e mëtejshëm të krijimtarisë sonë letrare e artistike.

Të rritim vetëdijen për misionin e madh të shkrimtarëve dhe artistëve në shoqërinë tonë.

Një ndër problemet e rëndësishme, që ka ngritur gjithnjë Partia dhe që trajton gjerë shoku Enver në fjalën e tij të 20 Dhjetorit të vitit të kaluar, është ai i rolit të letërsisë dhe të arteve në formimin e botëkuptimit të ri në njerëzit dhe në shoqërinë tonë. Ky rol po bëhet përherë e më i madh në kushtet e sotme të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, kur lufta e klasave është e ashpër dhe presioni i jashtëm ideologjik borgjezo-revizionist vjen duke u stërholluar dhe egërsuar. Njeriun sot e kanosin shumë gjëra të këqia: ideologjitë reaksionare, kulturat dhe artet regresive, mbeturinat borgjeze e mikroborgjeze të botës së shembur, veset me prirje konservatore e burokratike, egoizmat dhe thashethemet. Letërsia dhe arti, që kanë në qendër njeriun, jo vetëm duhet ta mbrojnë edhe në jetë këtë njeri, por duhet të përpiqen për ta bërë atë të ndërgjegjshëm në luftën për përparim. Ato, bashkë me gjithë propagandën dhe punën e Partisë, janë një forcë e madhe për formimin e njeriut të ri. Për këtë arsye koha kërkon vepra militante me partishmëri të lartë dhe nivel të mirë artistik. Duke trajtuar këtë problem shoku Enver thotë: «Partia duhet të krijojë në njerëzit dhe në shoqëri atë botëkuptim, ato zakone, ato ndjenja, ato shije, atë etikë, atë filozofi revolucionare që të mos lejojë pikërisht as ringjalljen e as përhapjen e botëkuptimeve mikroborgjeze».

E gjithë kjo ka të bëjë me misionin e lartë, që kanë shkrimtarët dhe artistët në shoqërinë tonë, të cilët, me veprat e tyre, përditë edukojnë mijra e mijra njerëz. Ata gjithnjë kanë qenë të vetëdijshëm për këtë mision. Fryma militante e veprave të tyre tanimë ka hyrë në karakterin kombëtar të letërsisë dhe të arteve dhe është në traditën

tonë. Le të nisemi që nga Naim Frashëri, i cili, kur e kërkonte shoqëria shqiptare e atëhershme, tretej si qiri-ri për t'u ndritur njerëzve dhe shkruante «Historinë e Skënderbeut» dhe «Bagëti e bujqësi», apo «Këndime për çunat». Të kalojmë te shkrimtarët tanë partizanë, të cilët, bashkë me fishekët në vezme, mbanin edhe fletoret me këngë e vjersha. Atëhere kur Partia luftonte propagandën armike dhe demaskonte Ballin Kombëtar, bashkë me traktet e saj, shpërndante edhe «Epopenë e Ballit Kombëtar» të Shevqet Musarajt. Menjëherë pas çlirimit, kur po ringjallej fashizmi në botë, Llazar Siliqi shkruante poemën «Prishtina», e cila dënonte me indignatë krimet naziste. Në vitet e para të bllokadës së egër imperialisto-revizioniste shkruhej poema e Ismail Kadaresë «Përse mendohen këto male», që afirmonte qëndrueshmërinë stoike të popullit tonë në shekuj. Po në ato vite gatuhej «Busti i shokut Enver» nga Odhise Paskali, ku mishërohen vetitë e larta prej mendimtari dhe drejtuesi të udhëheqësit të Partisë dhe shtetit tonë. Në atë kohë Pjetër Gaci kompozoi këngën «Për ty Atdhe», që është bërë aq popullore për përmbajtjen e shëndoshë dhe formën e lartë artistike, pasi në të mishërohet fytyra e Shqipërisë së lashtë e të re. Të vijmë në vitet e mëvonshme dhe pikërisht pas Plenumit të 4-t të KQ të Partisë, kur para shkrimtarëve dhe artistëve shoqëria vuri detyra të tjera të rëndësishme për të forcuar partishmërinë proletare dhe për të rritur tendencën ideore të veprave kundër ndikimeve të huaja reaksionare. Në një kohë të shkurtër prej një viti e gjysmë, gjithë krijuesit tanë iu përgjigjën thirrjes së Partisë me vepra militante, duke dënuar shfaqjet e huaja me ndërgjegje të lartë qytetare. Ata treguan se me të vërtetë trungu i letërsisë dhe arteve tona ishte i shëndoshë dhe se ndikimet regresive ishin të pjesëshme. Këtë e tregojnë romanet e botuara pas Plenumit të 4-t të KQ të Partisë, si «Zgjimi» i Sterjo Spasses, «Zgjimi i Nebi Surelit» i Dhimitër Xhuvanit, «Shtigjeve të zëna» i Miço Kallamatës e të tjerë; e tregojnë poemat «Mesazhi» e Llazar Siliqit, «Drejt qindra shekujve shkojmë» e Fatos Arapit, ciklet me vjersha të Fatmir Gjatës, Ismail Kadaresë, filmat «Rrugë të bardha» i Viktor Gjikes dhe «Qyteti më i ri në botë» i Khanfise Kekos dhe të tjerë. Për frymën militante dhe për rolin e madh, që po luajnë në edukimin komunist të njerëzve flasin dy festivalet e këngës në Radio-televizion, i 1973-së dhe 1974-ës, tingujt e të cilëve vazhdimisht shpërndahen në eter dhe shkoj-

në gjer në caqet më të largëta të Atdheut tonë. Por një nga arritjet më të mëdha, që u bë një vatër e vërtetë e edukimit ideestetik të masave është Ekspozita Kombëtare e arteve Figurative, që u hap në Galerinë e re, në prag të festave të Nëntorit, vitin e kaluar. Ajo kurorëzoi me sukses gjithë përpjekjet e piktorëve dhe skulptorëve tanë për të vënë në zbatim detyrat, që shtroi Partia në Plenumin e saj të 4-t.

E bëme këtë «eskursion» nëpër disa kyçe të veçanta të zhvillimit të arteve tona për të treguar se si shkrimtarët dhe artistët tanë i janë përgjigjur veprimtarisë së Partisë sonë dhe kanë qenë në një front të përbashkët me propagandën e saj për formimin e botëkuptimit të ri revolucionar në njerëzit dhe në shoqëri. Megjithatë, nuk duhet harruar për asnjë çast misioni i lartë, që kanë shkrimtari dhe artisti në shoqëri dhe nuk duhet dehur nga arritjet e mira. Është mirë të kujtojmë se vala e ndikimeve të huaja borgjeze e revizioniste erdhi si rrjedhim i presionit të ideologjive reaksionare dhe faktorëve subjektivë, po edhe si pasojë e nënvleftësimit të misionit shoqëror të krijuesit në veprimtarinë dhe jetën e popullit. Atëhere kishte zëra, që pohonin se një vepër me përmbajtje të thellë politike na qënkëshe agjitacion dhe në fakt kërkonin art zbavitës. Kjo bëri që F. Paçrami të kërkonte në Ekspozitën e Pranverës, në artet figurative, temë të lirë, se gjoja qënkëshin lodhur me tema të mëdha. Një veprim i tillë të shpinte në izmat perëndimore. Ne ngaherë do ta pohojmë se apolitizmi është vdekje për artin, është shuarje e misionit të lartë të tij në jetën e njerëzve. E themi këtë se vlerat kulturore nuk mund të krijohen duke qenë apolitikë dhe ata, që kanë menduar kështu, kanë dështuar. Këtë e dinë mirë shkrimtarët dhe artistët tanë, prandaj gjithmonë kanë qenë njerëz politikë dhe kanë mbrojtur me këmbëngulje interesat e Atdheut në çdo etapë të vështirë të historisë sonë. Artin ata e kanë parë si fenomen shoqëror, të krijuar në kushtet e jetës së shoqërisë. Partia ka luftuar vazhdimisht për të formuar koncepte të reja e të drejta për talentin dhe artin, për artistin dhe shkrimtarin. Talenti vërtet është aftësia e veçantë e njeriut në krijimtarinë artistike, por ai zhvillohet nën ndikimin e kushteve shoqërore. Në këtë mënyrë dhe ai është pjellë e shoqërisë. Teoricienët borgjezë e revizionistë mundohen ta mohojnë vartësinë e talentit nga shoqëria për të rritur në këtë mënyrë artistë indiferentë ndaj çështjeve të revolucionit. Në shoqëri-

në tonë ne edukojmë talente me ideal të lartë estetik e shoqëror, i cili i ndihmon ata të njohin jetën me tërë kontradiktat e saj, me bukuritë dhe vështirësitë, me gëzimet dhe shqetësimet dhe të shohin qartë pozitiven, të ardhmen. Por shkrimtari dhe artisti me talent të madh apo të vogël kanë nevojë të edukohen dhe të formojnë koncepte të reja për krijimtarinë, mjeshtërinë dhe vetë talentin. Rritja e nivelit teorik të artistëve ndikon drejtpërsëdrejti në krijimtarinë. Shumë gjëra e fenomene në shoqëri nuk mund të kuptohen pa një formim teorik. Vetë trajtimi i kontradiktave antagoniste dhe joantagoniste, i tipikes dhe individuale kërkojnë një përgatitje të gjithanshme filozofike, përndryshe mund të bëhen gabime e shtrembërime. Me një përgatitje të thellë teorike dhe me një njohje serioze të jetës ne nuk do t'u bëjmë lëshime teorive dhe manierave të artit dhe të kulturës reaksionare. Artisti ynë nuk është «artist në vetvete». Ai, duke krijuar, u drejtohet njerëzve, bashkëkohësve të tij dhe ndan me ta mendimet dhe ndjenjat, duke zbuluar botëkuptimin dhe idealin e tij estetik. Edhe për kërkimet dhe eksperimentimet në krijimtarinë ne duhet të formojmë koncepte të reja e të patundura. Kërkime dhe eksperimentime novatore ne do të bëjmë, se kështu do të hapim rrugë të reja në letërsi dhe art. Por shkrimtari dhe artisti në këto eksperimentime kurrë nuk duhet të harrojnë misionin e tyre të lartë shoqëror, funksionin edukues dhe destinacionin e artit. Në qoftë se harrohet funksioni dhe destinacioni i artit, atëhere kalohet në eksperimentime të kota dhe në tema të vockla të padobishme për shoqërinë. Është e domosdoshme që të formohen bindje të forta edhe në artistët me përvojë, edhe në të rinjtë, se destinacioni shoqëror i artit dhe fryma e tij militante e qytetare nuk e ndrydhnin individualitetin artistik, por përkundrazi e çlirojnë dhe i japin krahë.

Duke u thelluar në mësimet e Partisë sonë, në veprat e shokut Enver, në idetë e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe në eksperiencën e kulturës përparimtare botërore, ne gjithmonë do të dijmë të dallojmë se cili është arti i vërtetë dhe cili është llustër e jashtme apo pillulë helmi. Art i vërtetë është ai që shpreh idealet e popullit dhe i shërben popullit, i cili ka patur gjithmonë dhe ka kërkesa të larta estetike. Këto kërkesa duhen respektuar. Formalizmi është qëndrim përcmues ndaj kërkesave estetike të popullit; prandaj ne duhet të formojmë bindje të forta përse e dënojmë formalizmin dhe çdo «izëm» tjetër.

Në këtë mënyrë rritet misioni i lartë shoqëror i artistit.

Nuk mjafton që vetëm shkrimtari dhe artisti të kenë vepra të përshkuara nga botëkuptimi ynë i ri revolucionar. Këto vepra duhet të bëhen pronë e gjithë shoqërisë dhe për to është e domosdoshme të flasë shtypi e shkolla, podjumi e skena, sheshi e salla. Atëhere rritet me të vërtetë roli i artit dhe letërsisë në shoqëri. Shtypi ynë letrar e artistik, «Drita» dhe «Nëntori», kanë bërë një punë të lavdërueshme pas Plenumit të 4-t të KQ të Partisë, duke ngritur probleme të rëndësishme të rolit të artit në shoqëri, të traditës dhe novatores, të karakterit kombëtar dhe frymës popullore etj. Me këtë ato kanë qartësuar mjaft çështje të misionit shoqëror të shkrimtarit dhe artistit. Pavarësisht nga këto arritje, ende ka pak përgjithësime teorike për funksionin e artit, duke u nisur nga vetë veprat e fuqishme, që kanë forcë mendimi e ndjenje. Edhe gazeta edhe revista kanë mundësi të dalin nga një farë ngurtësie. Shpesh vihet re që materiali shpërndahet nëpër faqet e gazetës apo revistës në parcella të barabarta pa evidentuar evenimentet e rëndësishme artistike. U shkrua një artikull, fjala vjen, për Ekspozitën Kombëtare të Arteve Figurative dhe me këtë e mbaroi misionin gazeta, se «kaq e paska racionin kjo ngjarje». Pak kohë më parë, u botua një lajm i ngurtë në «Drita» që këtë ekspozitë e panë 350.000 vizitorë. Kurrë nuk ka ndodhur në historinë e arteve tona figurative, që një ekspozitë të shikohej nga 350.000 njerëz. Por ne në artikujt tanë nuk thellohemi se cila është arsyeja e këtij vërshimi të vizitorëve. Arsyen e gjejmë në forcën e artit, në përmbajtjen e shëndoshë dhe nivelin e mirë artistik. Ky lloj arti e kryen mirë misionin e tij në shoqëri.

Për rritjen e rolit të letërsisë dhe artit në jetën tonë është e domosdoshme të ndihmojnë të gjithë, që nga botuesit dhe ekzekutuesit e gjer te drejtuesit e institucioneve shtetërore apo dikasterve. Le të marrim një fakt. Sot ka shumë sheshe në Tiranë që nuk kanë asnjë skulpturë monumentale, pa le pastaj pikturë monumentale! Ne kemi ndërtesën e ekspozitës së madhe «Shqipëria sot», ku mund të vendosej bukur skulptura e Mumtaz Dhramit «Lart frymën revolucionare», e cila i shkon plotësisht karakterit të kësaj qendre, ku ekspozohen realizimet tona, mudi dhe mendimi ynë. Në qendrat publike, në restorante e hotele, në shtëpi kulture e klube shpesh mungojnë pikturat e bukura të piktoreve tanë me ndjenja estetike e revolucionare. Ne duhet të

luftojmë që veprat e pikturës sonë të hyjnë gjerësisht edhe në shtëpitë tona. Edhe botimi i partiturave të veprave të kompozitorëve tanë, të këngëve, simfonive, rapsodive e operave pothuajse mungon. Doemos kjo pengon jo vetëm formimin e kompozitorëve të rinj, por edhe studimin dhe përhapjen e muzikës sonë, që është një nga degët e artit që luan rol të madh në edukimin e gjithanshëm të njerëzve tanë.

Problemi i misionit të letërsisë dhe arteve në shoqërinë tonë është i madh dhe i gjithanshëm si nga ana teorike, ashtu edhe nga ana praktike, prandaj është e domosdoshme që të trajtohet më gjerë edhe nga studjuesit, edhe nga vetë krijuesit. Ky problem ka lidhje të ngushtë dhe është i pashkëputur nga njohja e jetës, pasi sa më shumë të futemi në të, aq më të vërteta dhe militante do të jenë veprat tona.

Jeta njihet përmes tendencës ideore të krijuesit ndaj realitetit

Një ndër ato kyçe kryesore, që kap shoku Enver në fjalën e tij të 20 Dhjetorit 1974 është edhe roli i njohjes në krijimtarinë e artistit. Ai na mëson: «Një poet, që nuk e njeh realitetin, sado fantazi të zhvilluar që të ketë, nuk mund të bëjë dot një poemë të fuqishme. Në qoftë se fantazinë që ai ka e gërsheton mirë me realitetin objektiv të vendit, me jetën e gjallë të popullit dhe me shkrimet e tij lufton shprehjet plot fraza pompoze, ai mund të bëhet gjithashtu një shkrimtar me talent».

Këtë problem të madh shkrimtarët dhe artistët tanë e kanë patur ngaherë në qendër të vëmendjes, pasi është jetik për artin. Njohja e jetës filozofikisht ka të bëjë me teorinë leniniste të njohjes. Atë ne shpesh e kemi trajtuar vetëm në mënyrën praktike dhe, në të shumtën e rasteve, në frymë moralizuese, duke u agjituar shkrimtarëve dhe artistëve se si të zbresin poshtë në kantieri ndërtimi apo kooperativa bujqësore. Kryesorja është që ne të formojmë bindje të patundur se pa njohjen e jetës nuk ka as letërsi dhe as art të vërtetë. Të gjitha veprat më të mira të shkrimtarëve dhe artistëve tanë, që kanë hyrë në fondin e artë të letërsisë dhe artit, shquhen nga pasuria jetësore, nga realizmi i vërtetë, nga idealet e larta komuniste, nga fryma kombëtare etj. Ata shkrimtarë dhe artistë, që kanë dështuar, përveç mun-

gesave të tjera, si talenti dhe mjeshtëria, nuk e kanë njohur jetën dhe nuk kanë bërë përpjekje për t'u futur tërësisht në fushën e saj të gjerë. Njohje jete do të thotë të jetosh intensivisht me tërë problemet e shoqërisë sonë: ekonomike, politike, ideologjike, kulturore e artistike. Përvoja krijuese na mëson se veprimtaria shoqërore e politike e shkrimtarit dhe e artistit, pjesëmarrja e tyre në luftën ideologjike, brumosja me idealet komuniste u hapin horizonte të pafund për krijimtari të shëndoshë. Nga të gjitha këto vijmë në një të vërtetë të madhe se nuk mund të ketë njohje jete pa tendencën ideore. Tendencën ideore të hap sytë për të dalluar tendencat e zhvillimit shoqëror, të cilat mishërohen në veprat e letërsisë dhe artit. E themi këtë pasi, në disa raste, ka shkrimtarë dhe artistë që nisen «për të njohur jetën» në një fabrikë apo fshat pa një qëllim të caktuar, pa një tendencë. Atëhere ai rri në minierë, fjala vjen, dhe shkruan për dashurinë e bariut me bareshën, ose për kalanë e Rozafës. Krijuesit të vërtetë njohja e jetës i bëhet nevojë shpirtërore dhe nuk pret që t'i bëjnë moral të tjerët. Shkrimtarët Jakov Xoxa dhe Dhimitër Xhuvani edhe më parë, edhe tani kërkojnë me insistim për të shkruar në ato vende nga e kanë nxjerrë temën, se përndryshe nuk mund të krijojnë. Është e natyrshme që krijuesi zbret në terren për disa arsye: a) **për plotësimin e temës që ka gjetur**, b) **për të verifikuar në jetë atë që ka shkruar**, c) **për t'u freskuar me përshtypje të reja e për të gjetur tema nga realiteti objektiv**. Pra, njohja e jetës përmes shkruarjes në bazë nuk është fushatë apo festival për bujë. Ajo bëhet me tendencë dhe qëllim të caktuar krijues. Por njohja e jetës nuk kufizohet vetëm në muajt imediatë të krijimtarisë. Lidhja me jetën duhet të bëhet stil i jetës sonë artistike, natyrë e punës sonë. Kur të arrijmë ta bëjmë stil, kemi korrur me të vërtetë fitore. Njohja e jetës dhe qëndrimi mes njerëzve të punës dhe krijimit japin emocione të fuqishme dhe impulse të reja në krijimtari. Atëhere lexuesi i beson veprës së shkruar dhe ka respekt për dijenitë që i jep artisti. Lexuesi për këtë artist ka të drejtë të thotë: «Këtij unë i besoj, se i di gjërat!».

Njohja e realitetit tonë, e njerëzve të thjeshtë të punës dhe të krijimit është problem i mprehtë veçanërisht për krijuesit e rinj. E themi këtë pasi në mjaft nga krijimet e tyre në prozë, poezi, pikturë, skulpturë e muzikë ka një qark të ngushtë temash, idesh e mendimesh.

Në këto krijime ndjehet artificialiteti libesk dhe zbehësia skematike. Në vjershat e tregimet, që lexojmë në shtyp e në libra ka një farë monotonie dhe stereotipie. Konfliktet janë shpesh artificiale e të paqena, figuracioni nuk mbart mendime dhe përsëritet nga një poet tek tjetri, sikur të dilte nga një kokë e të shkruhej nga një dorë. Në pjesën më të madhe të tregimeve, p.sh., figura e fshatarit përshkruhet sipas një shtampe të paraskicuar. Ai del njeri me mbeturina patriarkale, një tip që nuk e le vajzën të fejojë me atë që do, një figurë që jepet pas interesit personal e ku ta di unë. Në tregime të veçanta kjo nuk bie në sy, pasi tipa të tillë ka në jetë. Por kur lexon dhjetë vëllime me tregime dhe në të dhjetë gjen të njëjtin tip, është me të vërtetë për t'u shqetësuar. Kësaj i thonë mungesë e theksuar e njohjes së jetës. Dhe në përgjithësi tema e fshatit të sotëm ka filluar të rrallohet në letërsinë tonë. Nga të 70 romanet, që u paraqitën në konkursin e madh të 30-vjetorit të Çlirimit, vetëm ndonjëri trajtonte temën e punës dhe jetës së fshatarësisë sonë kooperativiste. Sigurisht, kjo vjen nga njohja e pakët e realitetit të fshatit tonë të sotëm dhe duhet të na verë në mendime për t'u preokupuar edhe si krijues, edhe si qytetarë, pasi gjashtëdhjetë përqind e popullit tonë jeton në fshat dhe mungesa e kësaj teme tregon se arti nuk e ka vërtetësinë e plotë. Prandaj është e domosdoshme që lejet krijuese të shpërndahen me kritere më të drejta dhe të kalohen edhe në fshatra dhe ndërmarrje bujqësore. Por kryesorja është që të formojmë bindjen e ndërgjegjshme se letërsia dhe arti ynë pa temën e fshatit nuk mund të jenë plotësisht realistë. Ne duhet të thyejmë krejtësisht konceptin që kanë përkrahur F. Paçrami e T. Lubonja se tema e fshatit nuk na qenkëshe moderne, pasi e ardhmja i takuaka vetëm qytetit. Ky koncept është i rrezikshëm, antikombëtar dhe anti-shkencor. Edhe tema e klasës punëtore, megjithë arrijtjet e mira në vitet e fundit, trajtohet zbehtë, ngaqë jeta e punëtorisë sonë ende njihet përciptazi. Akoma kemi pak vepra, ku të trajtohet procesi i kalimit të fshatarit apo zanatçiu në punëtor, duke u pasqyruar transformimet e mëdha në botën e tij shpirtërore. Në disa vepra, tregime apo drama punëtori pasqyrohet në kuadratin e një skeme të caktuar, një figurë, që përplas grushtin përpara drejtorit, që thërret në emër të klasës me brutalitet. Dhe kjo bëhet për të treguar gjoja «shpirtin revolucionar». Por shpirti revolucionar nuk qëndron në

thirrjet dhe në tundjet e grushtit. Punëtori ynë është njeri i kulturuar, se është bartës i mendimeve dhe ideve më të përparuara të shoqërisë dhe përfaqësues i ideologjisë drejtuese. Me të njëjtën skemë pasqyrohet edhe gruaja e emancipuar, sidomos në drama. Ajo zakonisht lëshon deklarata para burrit të saj dhe shoqërisë: «Unë dua emancipim! Mos më pengoni! Do iki nga shtëpia!». Në këtë mënyrë bën efekt të kundërt të lexuesit dhe spektatorët. Me një grua të tillë skene s'besoj që të ketë qejf të martohet asnjë spektator! Të gjitha këto tregojnë se jeta e njerëzve tanë duhet njohur më thellë dhe më mirë. Pastaj duhen edhe studjuar disa procese zhvillimi të shoqërisë sonë, të klasave aleate, punëtorisë dhe fshatarësisë, të cilat, me transformimet socialiste të vendit, kanë bërë ndryshime të mëdha në jetë e psikologji, duke fituar cilësi të reja morale e shpirtërore. Prandaj, përveç njohjes së jetës, duhet edhe njohja e studimeve tona sociologjike e historike, njohja e arkivave dhe dokumentave të tjera të Partisë.

Ndonjëherë njohjen e jetës ne e marrim ngushtë, duke e kufizuar vetëm në largimin nga qyteti dhe kryesisht nga Tirana. Por kryeqyteti ynë ka një jetë të gjallë, që zien si deti. Në kryeqytet sot pihet qumësht më shumë se pihej ujë më 1939. Në kryeqytet ka një punëtor të përparuar, një inteligjencë të zhvilluar. Në shkollat e tij mësojnë mbi 50.000 nxënës e studentë. Për shkrimtarët e artistët jeta e kryeqytetit tonë duhet të bëhet burim frymëzimi dhe Tirana mund të kthehet në një «personazh» të vërtetë në letërsinë dhe artet tona. Shkrimtarët francezë Parisin e kanë me të vërtetë personazh. Edhe pa qenë në Paris, duke lexuar romane, të duket sikur ke ecur në rrugët e tij, aq i përhapur është ai në letërsinë franceze. Ne ende s'kemi një roman për Tiranën tonë.

Shpesh, kur flitet për njohjen e jetës dhe për zbritjen në bazë ne u drejtohem vetëm shkrimtarëve dhe artistëve që jetojnë në Tiranë. Kjo rrjedh ngaqë kemi ndonjëherë koncepte të ngushta për njohjen e jetës. Siç ka nevojë për ta njohur jetën shkrimtari dhe artisti që banon në Tiranë, ashtu ka nevojë edhe ai që jeton në një qytet tjetër. Pse nuk u shtruaka problemi i njohjes së jetës dhe zbritjes në bazë për një shkrimtar, fjala vjen, që jeton në Vlorë apo në Korçë? Të gjithë ne duhet ta njohim jetën e vendit, pulsën e saj në Shqipërinë socialiste, pavarësisht se në ç'krahinë apo qytet jetojmë.

Problemin e njohjes së jetës ne ende e trajtojmë pak dhe zbetë në shtypin tonë letrar e artistik. Është e nevojshme që të gjejmë mënyra e forma të larmishme për trajtimin e tij, pasi kjo do të ndihmonte në edukimin e talenteve të reja. Shkrimtarët dhe artistët me përvojë të madhe jetësore do të ishte mirë të tregonin në diskutime krijuese dhe në shtyp për frymëzimin nga jeta, për mënyrën se si ata i kanë gjetur tipat dhe se si i kanë rikrijuar. Kjo mund të arrihej edhe nëpërmjet reportazheve dhe shënimeve. Fatkeqësisht reportazhet e shtypit letrar janë të dobëta dhe pa jetë. Ato duhet të bëhen me dy qëllime: a) për të popullarizuar sukseset tona në gjithë fushat e jetës; b) për të studjuar jetën nga shkrimtari dhe artisti. Është e domosdoshme që të ndjehet nga lexuesi dora e shkrimtarit në reportazh dhe jo dora e një gazetari të thjeshtë. Reportazhi i dobët tregon njohjen e pakët të jetës nga krijuesi, tregon udhëtimin e tij si turist i huaj dhe jo si qytetar i këtij vendi.

Shoku Enver, duke trajtuar rëndësinë e njohjes së jetës, na këshillon: «**T'i mësojmë letrarët dhe artistët e rinj si ta lexojnë librin e hapur të jetës socialiste të vendit tonë, si ta studjojnë dhe si ta kuptojnë brendinë e këtij libri të mrekullueshëm. Të bëjmë që ata të dashurohen me çdo «gërmë» të këtij libri të jetës, të shohin dhe të ndjejnë rrahjen e fuqishme të forcës, të ndjenjave dhe të dëshirave të zjarra të popullit.**»

Ky «libër jete» mësohet duke ndenjur gju më gju me popullin, duke marrë pjesë në gëzimet dhe hidhërimet e tij. Artisti i mirë nuk është kurrë qibar. Ai shkon në punë pranë fshatarit e punëtorit, merr pjesë në dasma e në vdekje, në këngë e në ngushëllime. Kur di të këndojë, edhe këndon me fshatarët bashkë. Vetëm kështu ai njeh shpirtin e madh të popullit. Kjo nuk i duhet vetëm shkrimtarit, por edhe piktorit, edhe kompozitorit, edhe këngëtarit dhe aktorit. Ne ndonjëherë ankohemi se ka piktura, në të cilat figurat e njerëzve dhe peizazhet i ngjasin njëri-tjetrit dhe u mungon individualiteti. Ankohemi gjithashtu se në figurat e kompozimeve dhe portreteve në artet figurative mbizotërojnë vetëm dy ndjenja: gëzimi dhe vendosmëria ose zemërimi. Gëzimi tregon lumturinë, zemërimi tregon vendosmërinë revolucionare. Ky është një konceptim i ngushtë i jetës dhe një varfërim i ndjenjave. Ndjenjat dhe mendimet nuk mund të reduktohen dhe nuk mund të futen në tabelat e rregulloreve. Tipat e rinj, që nxjerr jeta dhe pasqyron

arti, zakonisht i thyejnë tabelat e rregulloreve të zyrave. Por kjo «thyerje» ka vlera të mëdha kur bëhet në bazë të parimit të partishmërisë proletare dhe nuk çënon misionin shoqëror të artit dhe destinacionin e tij.

Nga njohja e pakët e jetës ndonjëherë bëhen edhe lapsuse të pafalshme. Në tregimet me temë nga fshati, për shembull, bëhen gabime në tokat, barërat, pemët, kafshët e mënyrën e jetesës. Në një tregim, kalë të mirë autori quante kalin me këmbë të trasha. Një fshatar, kur ia lexoi i biri, qeshi: «Po t'i ketë këmbët e trasha, unë nuk e ble as për njëqind lekë, se nuk është as për vrapim, as për punë!». Ose në Ekspozitën e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut ishte një tablo, ku heroi një kombëtar hante bukë misri me fshatarët. Kështu edhe titullohej: «Bukë misri me popullin». Misri në kohën e Skënderbeut ishte akoma në Amerikë, se nuk kishte mundur të vinte as në Europën qendrore, as në Ballkan. Prandaj nuk duhet në asnjë mënyrë të nëvleftësojmë njohjen e jetës, qoftë edhe në gjërat elementare.

Njohja e jetës luan një rol të madh jo vetëm në zgjerimin e sferës së tematikës, por në tërë zhvillimin harmonik të gjinive të letërsisë dhe artit. Prandaj duhet të na bëhet bindje e papërkulur, bindje e vetëdijshme, stil pune.

Për një ecje harmonike të të gjitha llojeve dhe gjinive të letërsisë dhe arteve

Kyçi tjetër i rëndësishëm që ka kapur shoku Enver në fjalën e tij është ai i zhvillimit harmonik të llojeve dhe gjinive të arteve tona. Në këtë dokument të një vlerë të veçantë, trajtohen gati të gjitha llojet dhe gjinitë e krijimtarisë sonë, por theksi është vënë më shumë në poezinë, dramaturgjinë, kinematografinë dhe muzikën. Duke evidentuar vlerat e padiskutueshme në këto gjini, duke çmuar krijimtarinë më të shquar të shkrimtarëve dhe artistëve, udhëheqësi ynë ngre probleme të mëdha si në teorinë ashtu edhe në praktikën krijuese, të cilat kanë të bëjnë me përparimin e mëtejshëm të letërsisë dhe arteve.

Një nga arritjet më të mëdha të krijimtarisë sonë është zhvillimi harmonik i gjithë llojeve dhe gjinive të saj. Me këtë ne mund të pohojmë se letërsia dhe artet tona shkojnë me hapa të sigurt drejt një pjekurie të-

rësore. Para disa vjetve të shkuar, neve pothuajse na mungonin romani e opera, skenari e simfonia, telefilmii e opereta e plot të tjera. Në gjithë fushën e letërsisë dhe arteve printe poezia, e cila ka tradita të mëdha dhe përfaqësues të shquar të së kaluarës dhe të sotmes. Por në këta dy dhjetëvjeçarët e fundit çanë rrugën edhe llojet dhe gjinitë e tjera. Romani, që ka qenë një gjini fare pak e njohur në letërsinë tonë, filloi të zhvillohet me shpejtësi, duke dhënë tablo të gjera të luftës, punës dhe jetës së njerëzve. Zhvillimi i tij ia rriti peshën letërsisë sonë dhe ia shtoi epizmin dhe dramaticitetin, që e kërkonte koha. Në këtë mënyrë ai plotësoi një boshllëk të ndieshëm, që vihej re në artin tonë dhe tregoi se mundësitë dhe perspektivat e krijimtarisë sonë janë të mëdha. Sot ne mund të themi se romani është një ndër ato gjini që prijnë dhe që luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin ideoestetik të njerëzve. Ne jemi të sigurt se mbi 25 romane nga ata që u paraqitën në konkursin e 30-vjetorit të Çlirimit janë të botueshëm dhe duhet t'u jepen lexuesve.

Hapa të sigurt ka hedhur edhe skulptura monumentale, e cila, e bazuar në traditën e shëndoshë, që përfaqësohet nga vepra e Odhise Paskalit, ka njohur vitet e fundit arritje të mira dhe është bërë një art nga më demokratikët. Vetdet, sheshet dhe rrugët tona nga kaloi historia dalëngadalë po zbukurohen me monumente me vlera të shëndosha ideore e artistike, të skulptorëve tanë më të mirë O. Paskali, K. Rama, Sh. Hadëri, M. Dhrami apo H. Dule. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për gjithë artet figurative, të cilat po ecin me shpejtësi drejt ngritjes së tyre, duke e shëndoshur edhe për mbajtjen, edhe formën. Vetë Ekspozita Kombëtare e Arteve Figurative, e hapur për nder të 30-vjetorit të çlirimit të Atdheut, është një dëshmi e përparimit të mëtejshëm në këtë fushë. Krahas gjithë arteve tona ka ecur edhe muzika instrumentale e skenike. Ne sot kemi simfonitë tona, operat e baletet tona. Sukses i ndieshëm ka qenë, fjala vjen, baleti «Cuca e maleve», i Nikolla Zoraqit, i cili ka një karakter të theksuar kombëtar dhe një frymë të shëndoshë revolucionare.

Në lëmin e muzikës, gjinia më dramatike dhe më e përhapur është kënga, të cilën po e lëvrojnë me sukses kompozitorët tanë. Ajo, megjithë ndonjë lëkundje të vogël, ngrihet në baza të shëndosha kombëtare dhe krijohet nga gjithë kompozitorët.

Në rrugë të drejtë po ecën letërsia për fëmijë me gjithë gjinitë e saj që nga vjersha e gjer të romani. Me këtë letërsi tanimë po merren shumë autorë, veçanërisht të rinjtë. Shkrimtarët e kësaj letërsie po bëhen miq të ngushtë të të vegjëlve, të cilët janë nga lexuesit më të mirë. Por autorët e letërsisë për fëmijë është e domosdoshme të ngrenë nivelin artistik të veprave të tyre e të shkruajnë me një gjuhë më të kulluar e më të bukur, pasi librat e tyre ndikojnë shumë në jetën e përditshme të të vegjëlve.

Një gjini tjetër që është në zhvillim e sipër është satira e humori. Ajo ka realizime të mira veçanërisht në roman, tregim e karikaturë. Dobësi të ndieshme ka në komedi, e cila po bëhet tepër e rrallë në skenat tona. Që të përparojë satira dhe humori, bashkë me komedinë, duhet të kthjellohen shumë probleme, që kanë të bëjnë me trajtimin e kontradiktave antagoniste, dhe jo antagoniste me tipiken dhe individualen etj. Një ndihmë të madhe pas Plenumit të 4-t të KQ të Partisë për këtë gjini na ka dhënë fjalimi i shokut Mehmet Shehu në aktivin e Partisë në Tiranë, i mbajtur në vitin 1973. Në këtë fjalim ngriheshin shumë probleme të mprehta edhe për satirën dhe humorin, të cilat i diskutuan gjerësisht shkrimtarët.

Në përgjithësi, gjithë llojet dhe gjinitë letrare e artistike ecin harmonikisht dhe ruajnë frymën e shëndoshë kombëtare e socialiste. Por në procesin e zhvillimit disa prej tyre kanë nevojë për një shtytje të re. Tanimë është folur dhe shkruar për një farë prapambetjeje, që vihet re në dramaturgjinë, libretet e operave dhe në muzikën e saj, kritikën letrare e artistike dhe deri-diku edhe në kinodramaturgji. Ndërsa në teledramaturgjinë ne sapo nisëm të hedhim hapat fillestare, pasi është një art krejt i ri për vendin tonë. Shoku Enver, më 20 Dhjetor të vitit të kaluar, shtron detyra të rëndësishme për një hop cilësor në këto lloje e gjini të arteve. «**Është e domosdoshme, — thotë shoku Enver, — që dramaturgjia jonë të ngrihet në një nivel sa më të përsosur, t'u largohet banaliteteve, dhe jo vetëm t'i përgjigjet shkallës së sotme të kulturës së masave që frekuentojnë këtë teatër, por ky të jetë njëkohësisht frymëzuesi i një përparimi të mëtejshëm të shijeve dhe hovit revolucionar për një jetë më të kulturuar.**»

Problemi i dramës duhet të bëhet medoemos një çështje e të gjithëve. Nuk është aspak normale që, brenda një letërsie dhe arti të zhvilluar, të ndihet një pra-

pambetje serioze në dramaturgji. Ne kemi artistë të mirë e regjisorë të zotët, të cilët do të vinin dhe do të luain në skenë çdo dramë. Ndjaj tyre ne si krijues duhet ta ndiejmë veten borxhlinj. Akoma më borxhlinj jemi ndaj spektatorëve, që i presin dramat tona me aq dashamirësi dhe entuziazëm. «**Ne kemi artistë të mrekullueshëm, — thotë shoku Enver, — që, pa ngurruar aspak, i quaj të kalibrit botëror. Dhe këtu kam parasysh jo vetëm aktorë të vjetër, si Sandër Prosi, Pjetër Gjoka, Naim Frashëri, Tinka Kurti, Ndreke Luca, Pandi Raidhi, Skënder Sallaku etj., por edhe të rinj, si Rikard Ljarja, Demir Hyskja e disa të tjerë, djem e vajza që s'ua kam mësuar akoma emrat. Me këta aktorë të mrekullueshëm e regjisorë me talent që kemi, jo të bëjmë nja dy a tre filma në vit, po shumë më tepër, mjaft që t'u pregatisim skenarët dhe kushtet e punës e të jetesës së tyre. Këta, janë thesarë për ne, por nuk dimë t'i përdorim si duhet.**»

Ka ardhur një kohë që të kalojmë në zgjidhjen e këtyre problemeve praktikisht dhe të hidhemi në veprim, duke e parë çështjen e dramës, filmit dhe telefilmit me ndjenjën e përgjegjësisë qytetare. Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve dhe Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, me një komision të veçantë, t'u rekomandojë Kinostudios «Shqipëria e re» dhe drejtorisë së Televizionit romanet, novelat dhe tregimet që mund të ekranizohen dhe, për realizimin e tyre, të ngarkohen konkretisht shkrimtarë dhe dramaturgë. Ne mendojmë se mund të ekranizohen, p.sh., romane të tillë si «Zgjimi» i S. Spasses, «Para agimit» i Sh. Musarajt, «Një vjeshtë me stuhi» i A. Abdihoxhës, «Shtigjeve të zëna» i M. Kallamatës, «Lumi i vdekur» i J. Xoxes, «Tokë e ashpër» e T. Laços, «Zgjimi i Nebi Surelit» i Dh. Xhuvanit e plot të tjera. Gjithashtu mund të ekranizohen tregimet e bukura të N. Priftit, A. Kondos, Dh. S. Shuteriqit, F. Ballancës, F. Gjatës, V. Koreshit, K. Kostës, K. Blushit etj.

Nuk është normale gjithashtu që pas tetë vjetve mezi u pa një opera e re më shumë për arsye të mungesës së libreteve. Më sa jemi të informuar tani 4-5 kompozitorë po kompozojnë muzikë për opera të reja. Kjo është një shenjë e mirë dhe inkurajim edhe për kompozitorët e tjerë.

Është e udhës të themi që krijuesit duhet të shqetësohen më shumë për këto gjini, që ecin ngadalë. Ata, për hir të çështjes së përgjithshme, mund të «sakrifi-

kojnë» dhe ta shtyjnë punën për një novelë apo roman dhe të krijojnë një dramë apo skenar. Naim Frashëri, poeti ynë i madh i Rilindjes, kur e kërkonte koha dhe interesat e kombit, shkruante edhe «Këndime për çunat», duke sakrifikuar një vjershë apo poemë.

Shkakun e ecjes ngadalë të dramës ne duhet ta kërkojmë edhe në mungesën e dashamirësisë ndaj autorëve nga disa drejtori teatros. Me veprimet e tyre të ngurta ato i mërzhisin dhe i lodhin autorët. Ka drejtori teatros, që nuk ua pranojnë pjesët dramaturgëve vendës dhe ata nisen pastaj në qytete të tjera për të kërkuar skenën. Kur e shohin se, në një qytet tjetër, pjesa që e rrëzuan vetë doli me sukses, fillojnë e interesohen. Një prirje të tillë ka patur edhe Teatri Popullor i Tiranës. Kësisoj veprimesh kanë të bëjnë me tendencën e administrimit të artit, për të «qenë brenda». Këto drejtorë janë të pasigurta në mendime, pasi kanë nivel të ulët ideologjik dhe e njohin pak vijën dhe politikën Partisë në letërsi dhe arte.

Për mbarëvajtjen e dramës, filmit dhe telefilmit është e domosdoshme që pranë teatrove, Kinostudios dhe Televizionit të krijohen grupe dramaturgësh e skenaristësh. Edhe ata do të krijojnë, po edhe do të shpëtojnë drama e skenarë, duke bërë një punë intensive me autorët.

Lidhur me zhvillimin harmonik të gjinive shoku Enver i kushton vëmendje të veçantë poezisë, përparimin e së cilës ai e ndjek me interes të madh. Ajo në tërësinë e saj ecën në rrugë të drejtë dhe është në pararojë të të gjitha gjinive të tjera të artit. Pas Plenumit të 4-t të KQ të Partisë poetët kanë krijuar vepra militante në përmbajtje dhe formë. Ata kanë luftuar me sukses shfaqjet e figuracionit të errët dhe temat e vockla mikroborgjeze, që u vunë re vitet e fundit. Me këto përpjekje poezia sot ka një frymëmarrje më të gjerë dhe është optimiste. Megjithatë, ka mjaft probleme që shqetësojnë edhe poezinë në stadin e sotëm të zhvillimit të shoqërisë. Është e vërtetë se poezia jonë ka bërë një hop të madh cilësor, por duhet thënë se disa poetë nuk po e kapërcejnë nivelin që ajo ka arritur. Mjaft poetë, veçanërisht të rinj, në poezinë e tyre kanë pak mendime për njeriun e për jetën. Ndihet një numërim figurativ i gjërave, që shihen në jetë, ndihet një farë informacioni me figura dhe mungon sinteza. Në disa raste poezia ka filluar ta humbë atë pak tregim, atë pak substancë vargu,

prandaj shpesh bëhet abstrakte dhe pompoze. Është krijuar një mekanizëm poetik dhe brenda tij përpiqemi ta futim jetën, të futim gjërat e vogla dhe gjërat e mëdha të realitetit. Ky mekanizëm pengon që të shkruhen sidomos poema, pasi kjo gjini e madhe poetike është e pamundur që të hyjë në skemat mekanike. Vjersha me disa marifete figurative edhe mund të hyjë dhe të krijojë përshtypjen e rreme se vargu ka poezi. Që të shkruhen poema të fuqishme, poeti duhet të marrë pjesë në luftën ideologjike, të jetë prezent, të jetë aktiv në transformimet shoqërore revolucionare dhe jo një sositës i thjeshtë i ngjarjeve.

Poezia ka shumë probleme, por fatkeqësisht në pak kritikë kemi në trajtimin e tyre në këtë fushë. Kur shkruhet për poezinë, shkrimet bëhen si për prozën apo dramën. Në të vërtetë ajo ka specifikën e saj. Një kritikë e pasur me mendime dhe e shkathët në lëmin e poezisë do të orientonte dhe do të ndihmonte shumë veçanërisht poetët e rinj. Por edhe për poetët, prozatorët apo artistët e rinj ndihma më e madhe është njohja e thellë e vijës së Partisë, e luftës së saj për transformimet revolucionare në shoqërinë tonë dhe për mbrojtjen e fitoreve të socializmit dhe revolucionit. Formimi i bindjeve marksiste-leniniste, i botëkuptimit të ri për jetën, shoqërinë dhe artin do t'u hapë horizonte të gjëra edhe në krijimtari. Talentet e reja janë vlera të mëdha kombëtare, janë e ardhmja e artit tonë, prandaj duhet të merret me ta gjithë shoqëria, por, në radhë të parë, ne shkrimtarët dhe artistët me përvojë. Është e domosdoshme t'i inkurajojmë duke ua botuar shkrimet e mira, por edhe duke u bërë një kritikë të drejtë dhe konstruktive. Në këtë drejtim një rol të madh në edukimin ideoestetik të tyre luajnë diskutimet e gjalla krijuese për librat e veprat e të rinjve, këshillimet e mësimet e urta e të durueshme. Shtypi ynë, «Drita» e «Nëntori», kohët e fundit po bëjnë një punë të lavdëruar me forcat e reja krijuese, duke diskutuar për problemet e tyre. Kjo punë e filluar mbarë duhet të thellohet dhe pasurohet. Nga ana tjetër, për edukimin e tyre është mirë të ketë botime masive për mjeshtrinë artistike e për problemet më aktuale të artit dhe letërsisë. Ne bëjmë botime për perimet dhe kafshët, për barërat dhe shpendët, por botime të tilla me pak faqe si «Tipikja dhe individualja», «Arti dhe shoqëria», «Poezia dhe politika», «Fryma kombëtare dhe popullore», pothuajse nuk kemi fare. Këto botime nuk do të ndihmonin ve-

tëm talentet e reja, por edhe lexuesit dhe artdashësit për ta shijuar më mirë letërsinë dhe artin dhe për t'u orientuar në morinë e problemeve të sotme në këto fusha.

Poezinë gjithmonë e ka ndjekur kënga. Ato janë të afërta dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Ne kemi këngë të bukura të mbështetura në tabanin kombëtar. Më të goditurat prej tyre tanimë janë përhapur në masat e gjera punonjëse të qytetit dhe fshatit. Por, siç është pohuar gjithnjë, kënga jonë ka nevojë për një thjeshtësi më të madhe artistike. Nuk e tepërojmë po të themi se ajo ende është e vështirë për t'u kënduar. Kjo është arsyeja që po hyn me vështirësi në shtëpitë tona dhe në gëzimet familjare. Arsye tjetër, që mezi hyn, është edhe mungesa e larmisë tematike dhe e llojeve të këngëve. Që të hyjë një këngë edhe pranë një tavoline gëzimi, duhet të jetë e natyrës familjare, shoqërore, intime. Të tilla këngë ne kemi ende pak. Ne nuk duhet të bëjmë vetëm dy lloje këngësh: këngë festivalesh dhe këngë koncertesh solemne. Të bëjmë edhe këngë që t'i kemi pranë familjeve e vatrave.

Në zhvillimin harmonik të gjinive dobësi të theksuara ka kritika jonë letrare e artistike. Doemos nuk mund të mohohen arritjet e saj pas Plenumit të 4-t të KQ të Partisë në trajtimin e disa problemeve themelore të krijimtarisë, si ato të karakterit kombëtar, të traditës dhe novatorizmit, të satirës dhe humorit, të tipikes dhe individuale, të heroit pozitiv e të tjera. Gjatë kësaj kohe janë dalluar me shkrimet e tyre kritikët tanë më të mirë si R. Brahimi, D. Shapllo, K. Bihiku, e të tjerë, duke trajtuar probleme të rëndësishme të krijimtarisë sonë. Por përsëri kritika jonë vuan nga cektësia e mendimit dhe nga trajtimi frazist i çështjeve të letërsisë dhe artit. Trajtimi frazist i fenomeneve të artit është një mbeturinë e së kaluarës, nga e cila duhet të dalë kritika jonë. Shabllonizmi, ngurtësia, skema, inkonsequenca, eklektizmi, varfëria e gjuhës dhe mungesa e pasionit dhe e mendimit në mjaft raste kritikën tonë e bëjnë të palexueshme dhe herë-herë edhe të pakuptueshme. Akoma ajo nuk ka arritur të analizojë thellë proceset letrare e artistike dhe të dijë të dallojë më qartë filizat e reja progresive dhe elementët e vjetër regresivë. Në këtë mënyrë shpesh ajo nuk është realiste, si veprat që analizon. Prandaj, me të drejtë, shoku Enver i bën asaj një kritikë të thellë parimore. «Kritikët tanë, — thotë shoku Enver, — të jenë realistë,

ashtu siç janë veprat që analizojnë, të jenë të thjeshtë, të kuptueshëm, koncizë dhe të kapshëm nga publiku».

Në fjalën e shokut Enver arti konceptohet si një pasuri e madhe kombëtare, që i hyn në punë shoqërisë. Por kjo, si çdo pasuri, mund të keqpërdoret, mund të mosmirëmbahet. Kritika nuk duhet ta keqpërdorë këtë pasuri, por të dijë ta vlerësojë dhe ta mirëmbajë. Fatkeqësisht kritika jonë shpesh nuk di ta mirëmbajë. Ajo nuk di t'ua servirë lexuesve këtë pasuri. Edhe kur ua servir, nuk e inkadron në tërë krijimtarinë, por fenomenin artistik e merr të shkëputur. Krijimtaria e një artisti duhet të konceptohet si një gjë e tërë edhe kur flitet për vepra të veçanta. Kur analizohet një vepër, është e domosdoshme të thuhet se ç'vend zë ajo në krijimtarinë e autorit, por edhe në tërësinë e arritjeve të artit. Lexuesi ka nevojë për këtë inkadrim. Ka nevojë edhe për t'u rikthyer te veprat e mëparshme. E theksojmë këtë, pasi, po u shkrua njëherë për një vepër të mirë, si të thuash, u kalua radha dhe për të më nuk flitet. Kaq e pati racionin! Pastaj vepra fillon e zbehet. Mirëpo në çdo pesëvjeçar del një lexues i ri dhe ai ka nevojë të dëgjojë për atë vepër, për të cilën ti ke shkruar vetëm njëherë. Lexuesi ka nevojë të marrë përher informacion, të ketë brumë nëpër duar. Dihet se fenomenet letrare e artistike nuk janë të shkëputur nga njeri-tjetri. Kështuqë kritikës i duhet dialektika.

Po t'i shohë gjërat në mënyrë dialektike, do të bëhet edhe një ndihmëse e mirë për edukimin dhe orientimin e lexuesve në botën e madhe të artit. Kështu, ajo do t'i thotë lexuesit: ja ku e ke librin, unë do të ndihmoj.

Pjesa më e madhe e kritikës sonë botohet në shtypin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Një lexues me dijeni mesatare, duke lexuar shënime kritike dhe recensionet, e ndien se në mjaft raste këto shënime kanë nivel të ulët në kulturën e të shkruarit dhe ndonjëherë edhe inkompetencë dhe padituri. Është botuar në «Drita», p.sh., një recension për tregimet e zgjedhura të F. Gjatës, ku autori i këtij shkrimi, nga padituria dhe inkompetenca, ngatërron kapitujt e vëllimit me librat e shkrimtarit. F. Gjata e ndan librin në kapituj të tillë si «Rinia e prindërve», «Thinjët», «Nëpër botë». Këta kapituj kritikë i kujton se janë libra dhe shkruan se tregimet e këtij vëllimi na qenkëshin nxjerrë nga librat «Thinjët»... etj.

Nuk janë të rralla rastet kur shënime kritike bien në kundërshtim me mendimin e përparuar të popullit. Pak ditë më parë, u botuan dy shënime kritike në «Dri-

ta» për filmat «Duke kërkuar pesorëshin» dhe «Qyteti më i ri në botë». Autorët e shënimeve, këtyre filmave të bukur u gjejnë të meta të trilluara nga koka e tyre; veçanërisht «Duke kërkuar pesorëshin» hidhej fare poshtë. Ky është një subjektivizëm i pafalshëm.

Kritika ndonjëherë vuan nga subjektivizmi dhe mania për të gjetur doemos të meta edhe atje ku këto nuk janë. Kjo kritikë është e përhapur veçanërisht në redaktorët e shtypit dhe të Shtëpisë Botuese «Naim Frashëri». Ka raste që autorëve u ndërrojnë fraza të tëra dhe u shkruajnë dialogë të rinj, pa i pyetur. Në romanin e Miço Kallamatës «Shtigjeve të zëna», në faqen 76, janë shtuar pesë rrjeshta dhe një dialog. Po e lexoj dialogun e shtuar nga redaktori:

— Jo! Në asnjë mënyrë, rrezikojmë kryerjen e detyrës!

— Ç'të presim? Ata po na vijnë drejt e në pozicion.

— Po na erdhën këtu, pushka top të na bëhet!»

Redaktori kujton se po ia shtoi fjalinë «pushka top të na bëhet», ia rriti frymën revolucionare romanit!

Po në këtë roman, në faqen 234, rrjeshti 29, fraza e autorit «**Ja, partizanët dolën, tani duhet të çelin gjethet**» është hequr dhe është zëvendësuar me xhevahire nga arsenali i redaktorit: «**Ja, sa u bëmë! Çdo ditë radhët tona partizane po shtohen pambarim!**».

Për të treguar se si ia heq shpirtin redaktori një veprë, le të përmendim një shembull tjetër të hidhur. Gaqo Kollumbi (Yrka) po boton një libër me kujtime. Në një vend, ai kishte një episod të tillë: Në shtëpinë e një fshatari, në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare bëhej mbledhja e çelulës së Partisë. Në mbledhje ishte edhe i biri i të zot të shtëpisë. Në të mbyllur të mbledhjes, hyn fshatari dhe ulet pranë Teki Kolanecit, komisarit. Dialogu ka qenë pak a shumë ky:

— Mos jam i tepërt?

— Jemi në mbledhje të Partisë, more baba! Nuk mund t'i themi të gjitha gjërat hapur! — i thotë i biri.

— Ore, nga na dole ti? Si nuk qenkam unë në Parti? Po ti a nuk ke dalë nga kjo kockë? — iu hodh fshatari të birit.

— Dale, mos e merr rrëmbyer. — i tha Tekiu.

— Prit, se edhe më ty Teki e kam! Edhe ti, kur hyra unë, sikur i shtrembërova buzët. E di që Partia ka edhe gjëra të fshehta, por jo për mua! — tha fshatari.

Këtë episod të bukur redaktori ia heq autorit, duke

i thënë se duhej ta përzinin fshatarin nga mbledhja, se statuti nuk e pranon këtë. Ama logjikë! Po ku ke fakt më të bukur, ku tregohet lidhja aq e ngushtë e popullit të thjeshtë me Partinë? Heqja e këtij episodi është me të vërtetë veprim prej burokrati.

Këto janë gjëra të palejueshme dhe arbitrare, që cënojnë të drejtën e autorit, e cila është sanksionuar me ligje të veçanta. Pikërisht këto qëndrime i dënon Partia. «**Nuk do të ishte aspak e rekomandueshme, — thotë shoku Enver — që dikush t'i thoshte, për shembull, një shkrimtari ose një tjetri: «Sikur t'i heqësh këtë ide ose varg e t'i shtosh atë tjetrin, sikur të shkurtosh pak këtu e ta zgjatësh atje, të heqësh këtë figurë artistike e të vesh një tjetër» etj. Në një rast të tillë, — vazhdon shoku Enver, — shkrimtari do të kishte të drejtë t'i thoshte bashkëbiseduesit: «Atëhere bëje më mirë vetë ti një vjershë ashtu si të pëlqen dhe mua mos më ngatërro!».** Nuk duhet tepëruar duke ndërhyrë me kritikë pa vend të veprave letrare-artistike, sepse një ndërhyrje e tillë subjektive nuk është ndihmë, por masakrim».

Akoma më pas është kritika artistike në sektorët e arteve figurative dhe në muzikë. Në këto fusha kritikët janë shumë të pakët, prandaj problemet trajtohen rralë-tek dhe me varfëri të theksuar mendimi e gjuhe. Ndonjë artikull, që botohet, është i mbushur me frazeologji dhe terma profesionale, gjë që e vështirëson kuptimin. Ka autorë, që mendojnë se sa më shumë terma profesionale të ketë artikulli, aq më vlerë shkencore ka shkrimi. Shkrim prej specialisti të vërtetë, nuk do të thotë shkrim profesionalizmas. Zbulimi i vlerave ideore e artistike dhe analiza e thellë shkencore bëhet duke arsyetuar dhe gjykuar mbi veprën, mbi idetë e saj, mbi problemet e saj dhe nuk bëhet vetëm duke radhitur disa terma të profesionit në muzikë apo pikturë.

Duke ndjerë dobësitë e kritikës, nga një anë, po edhe mungesën e kritikëve — pasi ata janë të pakët — është e nevojshme që të shkruajnë dhe të japin mendime akoma më shumë edhe krijuesit vetë. Eksperienca e tyre krijuese ndihmon në dhënien e mendimeve të drejta dhe konstruktive për letërsinë dhe artin. Veç kësaj, duhet të tërhiqet më shumë mendimi i masave të gjera punonjëse — punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve, nxënësve dhe studentëve. Kjo do të pasurojë edhe mendimin kritik. Në këtë fushë shtypi ynë, «Drita» dhe «Nëntori», mund të bëjnë një punë më të mirë, duke botuar rubrika të tëra

me mendime të masave. Gazeta «Drita» dhe revista «Nëntori» në këto numrat e fundit, pas botimit të fjalës së shokut Enver, janë gjallëruar dhe kanë përmirësime të ndieshme. Shkrimet e tyre kanë patur një nivel të mirë artistik e shkencor. Vetëm se puna për ngritjen e nivelit artistik e shkencor të shtypit duhet të vijë duke u thelluar.

Dihet se për kritikët nuk kemi shkolla të veçanta. Ata formohen e edukohen duke studjuar eksperiencën e Partisë sonë në pasurimin e mendimit teorik në lëmin e estetikës dhe në arte. Edukohen gjithashtu duke mësuar nga klasikët e marksizëm-leninizmit dhe duke ndjekur hap pas hapi procesin e zhvillimit të letërsisë dhe arteve tona. Por mirë do të ishte që herë pas here të bëheshin seminare e kurse me kritikët e rinj, të organizoheshin diskutime krijuese nëpër redaksitë e gazetave letrare e artistike dhe në ato të botimeve. Këto redaksi duhet të luajnë rolin e edukuesve të tyre, e grumbullimit rreth tyre, e frymëzuesve të tyre. Një veprimtari e tillë do të shtonte bashkëpunëtorët dhe do ta pasuronte shtypin. Një ndihmë të madhe në formimin dhe edukimin e kritikëve duhet të luajnë Universiteti ynë dhe Akademia e Shkencave. Edhe këto qendra të mëdha mund t'i aktivizojnë gjerësisht, veçanërisht në studimin e problemeve të letërsisë dhe artit të sotëm. Shumë probleme, që ka ngritur edhe Plenumi i 4-t, edhe shoku Enver në fjalën e tij të 20-dhjetorit kërkojnë një trajtim të thellë teorik. Disa herë këto probleme të mëdha simplifikohen dhe merren ngushtë pa e shtrirë mendimin gjerësisht nga arti në shoqëri e nga shoqëria në art. Kritika jonë duhet të mësojë nga dokumentat e Partisë për t'i lidhur ngushtë problemet e artit me ato të zhvillimit tonë shoqëror. Lidhja e tyre shpesh bëhet në mënyrë të thjeshtëzuar dhe të banalizuar me frazeologjinë e përditshme burokratike. Mos harrojmë se elementi burokratik nuk është vetëm në ndonjë tavolinë zyre, ai është edhe në tavolinën e kritikut, bile ndonjëherë edhe të shkrimtarit dhe artistit.

Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të punojë me shumë mënyra e forma për të frymëzuar krijuesit

Për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve dhe të degëve të saj në rrethe ka rëndësi të veçantë përmirësimi i vazhdueshëm i me-

todës dhe i stilit të punës drejtuese nga gjithë forumet, organizmat dhe qelizat e saj. Fjalimi i shokut Enver i 20 Dhjetorit 1974 hedh dritë edhe në mënyrat e format e veprimtarisë të organizatës sonë krijuese. Ai na mëson: **«Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve nuk duhet lejuar që të kthehet në një organ kontrolli të shkrimeve të ndryshme të të gjithë shkrimtarëve dhe poetëve të vendit, por, në radhë të parë, të punojë në shumë mënyra e forma për t'i frymëzuar ata që të shkruajnë sa më mirë».**

Ky këshillim shumë me vlerë i shokut Enver duhet të na verë të gjithëve në mendime për ta bërë organizatën tonë një qendër të vërtetë frymëzimi për krijuesit, «ku të rrihen gjallërisht mendime filozofike, artistike, estetike etj.» Por kjo arrihet atëhere kur të gjithë ne, Komiteti Drejtues, Kryesia e mbarë krijuesit, anëtarët e kandidatët e Lidhjes, të bëjnë një jetë të gjallë kulturele e artistike dhe bashkërisht të shqetësohen për problemet e letërsisë dhe të artit. Për këtë është e domosdoshme të ndiqet hap pas hapi procesi i zhvillimit të letërsisë dhe të artit, të njihen mirë gjithë fenomenet e reja krijuese dhe prirjet dëmprurëse jo vetëm nga forumet drejtuese dhe organizmat e Lidhjes, por nga çdo anëtar e kandidat i saj. Pa këtë njohje nuk mund të ketë as drejtim të mirë dhe as veprimtari të vërtetë krijuese. Kur njihet me kompetencë tërësia e krijimtarisë, prirjet e saj, elementet e reja, që prijnë dhe shfaqjet e huaja, atëhere edhe plenumet, edhe konferencat, edhe aktivet, edhe diskutimet tona krijuese bëhen të gjalla, problematike, interesante dhe frymëzuese. Atëhere gjenden edhe temat reale, që meritojnë diskutim e debat dhe janë të lidhura me nevojën dhe kërkesën tonë. Përndryshe, kur nuk janë reale, ato qëndrojnë jashtë interesave të krijimtarisë.

Pas Plenumit të 4-t Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve nën udhëheqjen e Partisë ka zhvilluar një veprimtari të gjerë e të gjithanshme për edukimin politik dhe ideestetik të krijuesve. Debati i madh ideologjik, që zjeu për një kohë të gjatë dhe që vazhdon në radhët e shkrimtarëve dhe artistëve, u bë një shkollë e vërtetë për të rrahur shumë mendime teorike e praktike të krijimtarisë. Por ne na ka shqetësuar gjithnjë fakti që ky edukim ideestetik ka patur raste që nuk është bërë për t'i shërbyer drejtpërsëdrejti krijimtarisë dhe ka qenë disi i shkëputur nga hallet e saj. Të marrim një shembull. Për tipiken në letërsi e art është folur mjaft në diskutimet tona dhe është shkruar shumë. Por këto diskutime

krijuese në mbledhje e në gazeta e revista nuk janë lidhur konkretisht me veprat dhe shqetësimet tona. Atëhere ato kanë marrë format e një trajtimi burokratik e frazist të fenomeneve artistike. Kohët e fundit janë bërë disa diskutime të përgatitura me seriozitet, ku janë rrahur mendime shumë të dobishme, si ai për tre poetët e rinj. A. Mulaj, H. Alia dhe S. Buçpapa. Ky diskutim i gjerë ndihmoi jo vetëm ata tre poetë të rinj, por edhe të tjerët, që kanë një përvojë të gjatë në poezi.

Edhe në probleme të tilla si karakteri popullor i artit ka përzierje e ngatërresa. Karakteri popullor ngatërrohet me karakterin kombëtar e me artin e bazuar në folklor. Vepër me karakter popullor nuk është identike me vepër të bazuar në folklor. Vepër me karakter popullor është çdo vepër, që shkruhet në kushte të caktuara historike, përhapet gjerë në njerëzit, përshkohet nga fryma popullore dhe shpreh idealet shoqërore dhe estetike të popullit. Edhe «Përse mendohen këto male» e I. Kadarese është vepër me karakter popullor, megjithëse nuk i ka mjetet shprehëse të folklorit, është me karakter popullor siç mund të jetë «Epopeja e Ballit Kombëtar» e Sh. Musarajt dhe «Bagëti e bujqësi» e N. Frashërit. Vepër e bazuar në folklor është, p.sh., «Heronjtë e Vigut» e K. Jakovës, që mund të ketë po ato vlera. Por «Përse mendohen këto male», që është me karakter popullor, nuk mund ta quash vepër të mbështetur në folklor! E them këtë se ne quajmë vepër me karakter popullor vetëm ato, që janë mbështetur drejtpërdrejt në folklor. Pra, shpesh edukimin ideoestetik ne nuk e bëjmë në shërbim të krijimtarisë, por si diçka më vete, si diçka për kulturë të përgjithshme. Atëhere ai bëhet i mërzhitshëm. . .

Në edukimin ideoestetik hyjnë edhe probleme të tjera njohëse dhe praktike për gjendjen e krijimtarisë së rrethëve të veçanta e qyteteve të veçantë. Ne asnjëherë nuk kemi bërë një studim të tillë, fjala vjen, pse në Korçë nuk ka kompozitorë? Cilat janë arsytet? Në Fier, Lushnjë e Berat ka, në Korçë pse s'ka? Ne nuk kemi bërë një studim se si është raporti i zhvillimit të sektorëve të artit, fjala vjen, në Vlorë. Cila është më përpara, piktura apo letërsia? Në këto studime të nxjerrim shkaqet e ecjes përpara të një fushe dhe prapambetjes së një tjetre. Në qoftë se problemet e edukimit ideoestetik do të lidhen kështu me krijimtarinë, atëhere do të kemi mjaft dobi.

Një jetë e tillë ideologjike e artistike me probleme reale e me preokupime reale, pa formalizëm, do ta forconte akoma më shumë edhe atmosferën tonë shoqërore krijuese. Është e vërtetë se sot kemi një atmosferë të mirë krijuese dhe ka një mirëkuptim gati në të gjitha problemet kryesore. Por në qoftë se diskutojmë më tepër për krijimtarinë e njëri-tjetrit, në qoftë se zhvillojmë debate në bazë të parimeve të estetikës sonë, atmosfera në Lidhje do të bëhet më e shëndoshë dhe nuk do të sëmuret kurrë.

Atmosferën e përgjithshme e forcojnë edhe marrëdhëniet e mira shoqërore për hir të mbarëvajtjes së punës me Ministrinë e Arsimit e Kulturës, me Shtëpinë Botuese «Naim Frashëri» dhe me institucione të tjera kulturore e artistike.

Në krahasim me dy-tre vjet të shkuara ne kemi bërë përmirësime të mëdha në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tonë. Doemos ende ka mundësi për rritjen e këtij bashkëpunimi edhe për rrahjen e atyre mendimeve, që na shqetësojnë të gjithë ne së bashku, si për problemet e dramaturgjisë, filmit, telefilmimit, muzikës e të tjera.

Ne do të dëshironim që të bashkëpunonim më ngushtë, për shembull me Televizionin, i cili kurrë nuk ka marrë inisiativën për të këmbyer ndonjë mendim me Lidhjen për problemet e tij të shumta aktuale. Vetëm kohët e fundit kemi këmbyer ndonjë mendim të dobishëm lidhur me zgjidhjen e çështjes së telefilmave. Edhe me Shtëpinë Botuese «Naim Frashëri», me gjithë përmirësimin e theksuar të marrëdhënieve tona, ende ka fushë për të bërë konsulta të përbashkëta, veçanërisht për shpejtimin e procesit të botimit të librave. E theksojmë këtë, pasi botimi i librave tona vonohet shumë dhe koha e recensionit dhe redaktimit të tyre zgjatet pa masë dhe i kalon të 7-8 muajt gjersa veprat të shkojnë në shtyp. Kjo bën që librat të dalin një nga një me ritme tepër të ngadalësuara. Ne i kuptojmë vështirësitë objektive, megjithatë ka mundësi që gjendja të përmirësohet.

Problemet e mëdha, që dalin para letërsisë dhe artit kërkojnë vetvetiu edhe përmirësimin e punës së Lidhjes me degët e saj. Ato janë organizma të të njëjtës organizatë dhe duhet që veprimtaria e tyre të harmonizohet me gjithë aktivitetin krijues të saj. Pas Plenumit të 4-të jeta letrare e artistike e tyre është gjallëruar shumë me diskutime krijuese, me rrahje mendimesh e me trajtimin e mjaft problemeve të lidhura ngushtë me

krijimtarinë. Dallohen veçanërisht dega e Shkodrës, e Vlorës, e Durrësit dhe e Elbasanit, ku ka një atmosferë të shëndoshë krijuese dhe një gjallërim të mendimit ideoestetik mes shkrimtarëve dhe artistëve. Në mjaft prej tyre bëhen diskutime të veprave konkrete dhe krijuesit janë të preokupuar për gjallërimin e jetës kulturore në qytetet ku jetojnë. Por mundësitë janë të shumta për një veprimtari më intensive dhe për një interesim më të madh për jetën artistike të qyteteve, për pjesëmarrjen aktive në shtëpitë e kulturës, estradave e teatrove. Lidhja e ngushtë me gjithë jetën politike e shoqërore të rrethit ku punojnë e krijojnë do t'i ndihmonte për një krijimtari më të shëndoshë e me nivel më të lartë artistik. Por kryesia e Lidhjes është e domosdoshme të bashkëpunojë më ngushtë me degët dhe t'i ndihmojë në zgjidhjen e mjaft problemeve të krijimtarisë së tyre.

Sukseset dhe të metat e punës së organizatës sonë krijuese vetvetiu pasqyrohen edhe në shtypin e saj.

Ne, si kryesi e Lidhjes, duke patur parasysh gjithnjë porosinë e shokut Enver, duke përmirësuar punën tonë me diskutime krijuese, «ku të rrihen gjallërisht mendime filozofike, artistike, estetike etj.», duemos do të ngremë lart edhe nivelin e shtypit tonë. Në qoftë se ngremë cilësinë e diskutimeve në plenum, konferenca, aktive, simpoziume e sesione shkencore, në qoftë se gjallërojmë diskutimet për vepra të veçanta e për krijimtarinë e shkrimtarëve dhe të artistëve më të shquar, do të frymëzojmë edhe shtypin. Kjo është një anë. Ana tjetër është që kryesia duhet ta drejtojë më mirë shtypin, t'i bëjë sugjerime e vërejtje, t'i hapë horizont, ta kontrollojë dhe t'i kërkojë llogari. Ne duhet ta bëjmë praktikë, që, kur është rasti, të thërresim në raport gjithë redaksinë e njerit prej organeve tona, të dëgjojmë mendimet e saj dhe të japim detyra dhe orientime të dobishme. Përveç kësaj, duhet që të ndjekim edhe veprimtarinë e kolegumeve dhe komisioneve pranë sektorëve për ta gjallëruar mendimin krijues dhe teorik. Nga ana e tij shtypi është e domosdoshme të ndjekë mirë problemet, që shtrojnë plenumet, kryesia, sekretariati dhe kryesitë e degëve. Ato probleme, që ngrenë këto forume, duhet të gjejnë jehonë të vërtetë në shtyp dhe jo me një informacion të thatë: «U mblodh kryesia...» Ne kemi rrahur në kryesi, fjala vjen, problemin e dramaturgjisë, ku u thanë mendime të vlefshme. Shtypi dha vetëm një infor-

macion të thatë. Ato materiale mund të shfrytëzoheshin për një artikull problematik. Punët duhen koordinuar mirë dhe propaganda letrare e artistike të ketë një qëllim të caktuar e të përqëndruar dhe jo të copëzuar. «Drita» dhe «Nëntori» janë të vetmet organe të specializuara, që përpunojnë mendimin letrar dhe artistik, prandaj nga ta kanë kërkesa të mëdha artdashësit dhe krijuesit tanë. Letërsia dhe arti tanimë janë bërë plotësisht pasuri e masave të gjera punonjëse, pasuri e gjithë popullit, dhe populli ka dëshirë të gjejë në shtypin letrar e artistik mendime të thella dhe gjuhë të kulturuar, siç është dhe ai vetë i kulturuar.

Si për shtypin e Lidhjes, si për gjithë organizmat e saj dhe për çdo krijues me përvojë të paktë a të shumë letrare-artistike, fjala e shokut Enver në Sekretariatin e KQ të Partisë ka hapur horizonte të reja mendimi dhe krijimi në punën e përditshme dhe në perspektivën e veprimtarisë. Mendimet dhe orientimet e udhëheqësit tonë të dashur do t'i japin një nxitje të re letërsisë dhe arteve tona për të kaluar në një hop tjetër cilësor në rrugën për zbatimin e detyrave të mëdha, që vuri Plenumi i 4-t i KQ të Partisë. Shkrimtarët dhe artistët, duke ndier ngrohtësinë dhe interesimin e vazhdueshëm të Partisë, duke patur përreth dashurinë dhe respektin e popullit për punën e tyre, duke qenë të vetëdijshëm për misionin e lartë, që kanë në shoqërinë tonë si edukatorë të njerëzve, do të krijojnë vepra akoma më të fuqishme, të mbrujtura me ide të larta të epokës sonë të lavdishme e të mëkuar nga gjuha e kulluar dhe e bukur e popullit tonë. Me këto vepra ata do t'i sjellin gëzime të reja popullit, Partisë dhe shokut Enver, udhëheqësit tonë të dashur, që kujdeset aq shumë për lulëzimin e kulturës dhe arteve tona socialiste.

Nga diskutimet në plenum

Sterjo Spasse: RINI E PËRJETSHME E REALIZMIT SOCIALIST

Shoku Enver na mëson: «Në rast se arrijmë të pregatisim vetë përkthyes të zotë në gjuhët e huaja... , ne do të kemi shumë sukses në popullarizimin e krijimtarisë letraro-artistike shqiptare jashtë Atdheut». Ky është një pohim, që na i mbush zemrat me gëzim. Me të vërtet mund të flitet shumë për sukseset e prozës, të poemës e të poezisë sonë. Veprat letrare më të mira përfshijnë një tematikë të gjerë e kanë paraqitur tablloja e aspekte nga më kryesoret nga epokat e ndryshme shqiptare, kanë trajtuar konflikte antagonistë e joantagonistë e kanë krijuar personazhe të gjalla pozitive e negative. Ato janë gatuar me frymën shqiptare dhe kanë vënë në qendër të vëmendjes masën punëtore shqiptare. Ato kanë sjellë në tribunën e nderit të letërsisë sonë, me tërë forcën artistike, edhe njeriun e kohës, njeriun e ndërtimit të socializmit, komunistin. Ato kanë kapur probleme kyçe të jetës shqiptare dhe u kanë provuar katërcipërisht edhe revizionistëve, edhe dekadentëve të perëndimit, se metoda e realizmit socialist është një metodë konkrete krijuese, rinia e saj e përjetshme i ka rrënjët në aftësitë për të qenë kurdoherë në nivelin e mendimit progresiv më të lartë të kohës. Sukseset tona ideoartistike, larmia e stileve, galeria e gjerë e personazheve pozitive e negative, zgjerimi dhe thellimi i tematikës pohojnë fare qartë se metoda e realizmit socialist zhvillohet pareshtur, përtërihet pareshtur duke pasuruar fondin e vet gjatë pasqyrimin të transformimit revolucionar të realitetit. Këto suksese të letërsisë dhe të arteve tona në përgjithësi pohojnë atë, që mohojnë ideologët revizionistë e imperialistë, pohojnë fitoren e përndërprerë të metodës së realizmit socialist.

Tani ajo pjesë e vogël e letërsisë sonë, që është përkthyer nga krijimtaria e Ismail Kadaresë, e Dritëro Agolli, Lllazar Siliqit e të tjerëve, si edhe ekspozita e madhe «Arti shqiptar në shekuj», hapur këta muaj në Paris, i

detyroi shumë kritikë të letërsisë e të artit borgjez të pohonin atë, që mohonin më parë: të njohin artin e mrekullueshëm shqiptar, letërsinë e mrekullueshme shqiptare. Ky pohim aq pozitiv është një sukses i madh në shkallë kombëtare e ndërkombëtare i letërsisë dhe i artit tonë socialist. Sepse në vendet kapitaliste e revizioniste zakonisht një pjesë e madhe e kritikëve flasin mirë kur u lbyren sytë nga shkëlqimi i florinjve, se konkurenca e një shtëpie botuese me tjetrën, konkurenca e një rryme letrare me tjetrën, e një mikut me kundërshtarin, e një partie me tjetrën është barometri i vlerësimit të një veprë letrare dhe artistike. Kurse në rastin tonë edhe kritikëve borgjezë më ekstremistë ua lbyri sytë shkëlqimi i vetë artit tonë shekullor e të realizmit socialist. Ata u gjendën përballë një populli të vogël me një art të madh.

Dashur pa dashur ata kanë pohuar një të vërtetë të madhe dhe kjo e vërtetë e madhe është se metoda e realizmit socialist, që është braktisur në vendlindje nga revizionistët në fuqi, në Shqipërinë socialiste u ka vënë krahë shkrimtarëve e artistëve shqiptarë, sa që ata me artin e tyre të lartë po depërtojnë tej bllokadave për t'u bërë pronë e artit përparimtar të përbotshtëm e për të dhënë ndihmën e tyre në zhvillimin e kulturës përparimtare.

Veçse edhe nga ana jonë duhet një aktivizim më sistematik, më këmbëngulës për të propaganduar letërsinë e artin tonë jashtë kufijve. Për shembull, shumë manuale të ndryshme të shkruara në gjuhë të huaja ose shënime të botuara si informacione nëpër enciklopeditë e injorojnë ende letërsinë e artin tonë të këtyre tridhjetë vjetëve të çlirimit dhe vënë në pah ndonjë shkrimtar dekadent e fashist ose ndonjë, që s'i është dëgjuar as emri. Për shembull, kritiku anglez Eduard Mani, në manualin e tij «Letërsia shqipe», i vetmi libër i botuar për letërsinë shqipe në anglisht, jo vetëm që injoron në mënyrë të plotë letërsinë tonë të realizmit socialist, por ai hesht në mënyrë cinike edhe për njërin nga shkrimtarët tanë më të mëdhenj para çlirimit, për Migjenin. Arbëreshi Xhuzepi Skiroi Junior, në librin e tij «Historia e letërsisë shqipe», botuar italisht, e kapërdin me disa radhë tërë letërsinë tonë të pasçlirimit, ndërsa nuk lodhet duke e ngritur në qiell, në faqe të tëra, dekadentin e fashistin Ernest Koliqi me shokë.

Në enciklopeditë italiane, angleze, gjermane e gjetkë jo vetëm që gjejmë një kurnaci, por edhe një injorancë të plotë përsa i takon njohjes së letërsisë e të artit tonë so-

cialist si edhe atyre të paraçlirimit. Bën përjashtim këtu anciklopedia e madhe franceze Larus (Larousse), e cila në vëllimin shtojcë të vitit 1969 ka një informacion shumë të drejtë, madje ka edhe në zërat e përshtatura të alfabetit njohuri të sakta e të mjaftueshme për disa nga përfaqësuesit e letërsisë sonë. Pa dyshim, kjo është një përpjekje vullnetmirë nga ana e hartuesve të enciklopedisë.

Dua të theksoj se në këtë mes neve na takon të bëjmë një përpjekje të madhe për t'i informuar këto qarqe. Si gjë e domosdoshme më duket se është botimi në gjuhë të huaj i një historie të letërsisë shqipe e të artit shqiptar, një histori e plotë, serioze, e përgatitur me një punë të përbashkët të Akademisë së Shkencave, të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe të Shtëpisë botuese. Na duhet edhe botimi i një fjalori enciklopedik a i një enciklopedie një a dy vëllimesh të «botës shqiptare», e domosdoshme kjo jo vetëm për lexuesin tonë, por edhe për botën e jashtme.

Njëkohësisht Lidhja jonë, Akademia e Shkencave, Shtëpia Botuese duhet të jenë në dijeni të plotë se çka flitet në shtypin e huaj për letërsinë e artin tonë, se çfarë përkthehet në gjuhë të huaj qoftë kjo edhe një poezi, jo më romane, poema e përmbledhje poezish e tregimesh. Shpesh për këto duhen informuar edhe lexuesit shqiptarë. Shpesh do t'i duhet Lidhjes ose Shtëpisë Botuese ose Akademisë t'u përgjigjet enciklopedive ose gazetave e revistave të huaja, që mund të botojnë jo të vërteta mbi artin e kulturën tonë. Këtë mund ta bëjnë ose me anën e shtypit, ose edhe drejtpërsëdrejti.

Të mos harrojmë se nga fjala e shokut Enver e 20 dhjetorit 1974, që është një sintezë dhe vlerësim i lartë i sukseseve të gjertanishme të letërsisë e të arteve tona, del se Partia i ngarkon shkrimtarët dhe artistët, si kurdoherë, me një barrë të rëndë e me përgjegjësi jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare, që ta shpien lart e më lart artin e metodës së realizmit socialist, duke krijuar vepra sa më të përsosura ideoartistike. Dhe këtë do ta bëjnë patjetër shkrimtarët dhe artistët tanë, sepse si synim kanë pastërtinë ideologjike, partishmërinë, se ata kanë ndihmën e pakursyer e të pandërprerë të Partisë dhe të mësimëve të paçmuara të udhëheqësit tonë shokut Enver Hoxha, sepse ata punojnë kurdoherë në mes të vrullit të pandërprerë të ndërtimit të socializmit. Prandaj, e ardhmja e mbarë letërsisë dhe e artit tonë është e shkëlqyer.

Kujtim Buza: TË THELLOJMË NJOHJEN E JETËS DHE PASQYRIMIN E SAJ ME VËRTETËSI NË ARTET FIGURATIVE

Sukseset e deritanishme të arteve tona figurative, sidomos pas plenumit të 4-t të KQ të PPSH e në mënyrë të veçantë në Ekspozitën kombëtare të arteve figurative kushtuar 30-vjetorit të çlirimit të Atdheut, dëshmojnë në më së miri për një zhvillim të vrullshëm të tyre në të gjitha gjinitë e veçanërisht në skulpturën monumentale dhe kompozimin në pikturë. Në to janë realizuar vepra që trajtojnë probleme të rëndësishme, të cilat janë parë nga pozita të shëndosha marksiste-leniniste. Këto suksese janë arritur gjithashtu në saje të mbështetjes fort në traditat tona, në realitetin tonë socialist dhe të përvetësimit dhe të zbatimit të parimeve të metodës së realizmit socialist në pasqyrimin e jetës.

Për të merituar rolin e ndihmësit të Partisë në formimin e njeriut tonë të ri sikundër na mëson shoku Enver, duhet që krahas jetës intensive ideologjike të shtojmë punën tonë për studimin dhe përvetësimin e plotë të materialeve të Partisë, dhe në dritën e tyre të zhvillojmë diskutimet problemore dhe tekniko-profesionale, të njohim jetën dhe ta pasqyrojmë atë me vërtetësi. Si për të gjitha artet e tjera edhe për artet tona figurative ka rëndësi të madhe trajtimi i temës aktuale. Ky problem nuk duhet kuptuar në mënyrë të thjeshtëzuar, vetëm si pasqyrim i ngjarjeve të kohës së sotme, por në mendimin e rëndësishëm, që mbartin veprat, në trajtimin e temave të jetës së sotme, bile edhe atyre historike në shërbim të aktualitetit. Kjo arrihet duke njohur thellë jetën, epokën që pasqyrohet, duke e interpretuar atë me tendenciozitet klasor marksist-leninist dhe me partishmëri proletare, vetëm atëhere vepra do t'i shërbejë qëllimit aktual por edhe perspektivës së zhvillimit.

Të trajtosh tema apo motive, figura apo probleme, ngjarje apo subjekte, pa i njohur më parë ato mirë, pa i zbërthyer ato nga pozitat materialiste e dialektike e duke mos u marrë me çështjet thelbësore të problemit, nuk mund ta pasqyrosh drejt jetën. Të tilla raste kemi patur më parë, para plenumit të 4-t. Sot, veçanërisht duke pa-

tur parasysh ekspozitën e fundit flasim për arritje të mbështetura në kërkime dhe studime në kontakt të thellë me realitetin, duke e njohur dhe jetuar atë nga afër.

Por megjithë sukseset e arritura, duke u mbështetur edhe në porositë e fundit të shokut Enver që thotë se: «Që të shkruash vepra me vlerë duhet edhe kohë, pastaj duhet të lidhesh me njerëzit, me popullin, të futesh në gjirin e masave, jo vetëm sa për të gjetur subjektin e romanit ose të poezisë dhe të largohesh menjëherë nga fshati ose fabrika, duke e konsideruar të mjaftueshme lindjen e idesë», ne piktorët, grafistët edhe artistët aplikativë duhet të nxjerrim detyra për t'u shtruar këmbëkryq me njerëzit e për të njohur jetën në gjithë kompleksitetin e saj. Mungesa e njonjes së jetës reflektohet në krijimtari, veçanërisht të bie në sy në disa tablo që i kushtohen klasës punëtore, në vepra të tilla të mëdha si Metalurgjia, Ballshi, Fierza, Nafta etj., të cilat nuk të emocionojnë sepse autorët nuk arrijnë të pasqyrojnë në to karaktere të gjalla, me botë të brendëshme shpirtërore, me gjendje të veçantë psikologjike të heroit të tipizuar.

Karakterit monumental i veprës nuk duhet parë në zgjidhjen e jashtme, në trajtimin e sheshtë dhe të gjerë të sipërfaqeve, por në përmbajtje, në rëndësinë dhe forcën e saj përgjithësuese.

Në këtë anë më duket se ekziston një keqkuptim që vjen pikërisht nga mosnjohje sa duhet e jetës. Moskonkretizimi i lypave, realizimi në disa raste i punëtorit, fshatarit, ushtarit apo intelektualit si një njeri me tipare të përgjithshme, siç është vërejtur në disa raste, është një e metë që duhet mënjanuar sepse pengon pasqyrimin e karaktereve të gjalla në artet tona figurative.

E vërteta e jetës në gjerësinë e saj zbulohet nga artistët tanë në përputhje me origjinalitetin dhe individualitetin e tyre krijues, mbështetur gjithmonë në pozitën krijuese të artit të realizmit socialist. Por cilado firmë a individualitet krijues qoftë, të vërtetën e jetës e pasqyron nëpërmjet konkretizimit të shumë anëve, tipave, karaktereve dhe hollësive të tjera që duhen për të nënvizuar dhe zbërthyer idenë.

Me të gjitha këto që thashë, desha të dal këtu se — zgjidhja monumentale e veprës, përpjekjet që bëhen për të folur në pikturë me një gjuhë lakonike, nuk nënkupton mënjanimin e hollësive dhe detajeve në vepër, qoftë në figura, apo në ambientin rrethues siç është vënë re në ndonjë vepër. Këtu mund të mos jemi dakort me ato

hollësi që janë të parëndësishme dhe të dorës së dytë, por jo kurrësi me ato detaje tipike që ndihmojnë në zbërthimin e përmbajtjes së veprës.

Preokupimi dhe insistimi ynë i vazhdueshëm për të gdhendur tipa dhe karaktere, gjëndje të caktuara shpirtërore të heronjve tanë, është një problem i rëndësishëm i krijimtarisë në artet figurative, që në veprat tona të mos kemi vetëm dy gjendje psikologjike: heronj të qeshur apo seriozë, por t'i japim ata në larminë e gjithë gjëndjes shpirtërore që krijon atmosfera dhe realiteti ynë socialist. Prandaj këtë vit e më tutje ne do të thellojmë akoma më shumë lidhjen me jetën, në të gjitha format dhe mënyrat. Do të marrim përshtypje nga jeta dhe mbi to duhet të nxjerrim konkluzione, të realizojmë vepra — sintezë e punës në bazë për të mos mbetur me përshtypje të sipërfaqshme.

Por jetën duhet ta njohim të gjithë, në kontakt me të duhet të jenë edhe artistët aplikativë, të mbledhim motivet e popullit, artin popullor në gjithë pasurinë e tij, qëndisimat, gdhendjet, mjetet dhe orenditë, në veshjet dhe zbukurimet, që me aq dashuri janë ekzekutuar nga mjeshtrit popullorë. T'i grumbullojmë ato duke i zgjedhur, t'i përdorim në kritere të drejta dhe t'i thurim organikisht me motivet e reja, të lindura në epokën tonë të ndërtimit të socializmit.

Por edhe karikaturistit i duhet të njohë jetën. Piktori Z. Bumçi i ka veprat e tij të qarta, të kuptueshme dhe direkte, pasi ka ditur të vëzhgojë jetën dhe natyrën, duke grumbulluar tipa dhe karaktere. Por edhe piktori i mjeteve mësimore duhet të vizatojë e të jetë në kontakt me nxënësit e shkollave dhe të mos mbyllet në biblioteka. Po kështu grafisti, skulptori etj. Nga mosnjohja e jetës ka pasë raste që edhe kostumet tona popullore, të jenë bastarduar.

Puna me talentet e reja që lidhet me të ardhmen e arteve tona figurative është një detyrë e përhershme që duhet kryer jo vetëm nëpërmjet shembullit të veprave të krijuara nga artistët me përvojë, këshillave dhe konsultimeve të tyre, por edhe me anë të diskutimeve dhe analizave të krijimtarisë së të rinjve, me anë të patronazhit, të nxitjes në rrethet e vizatimit, përmes bashkëpunimit në realizimin e veprave, veçanërisht në gjinitë e pikturës dhe skulpturës monumentale. Shoku Enver kur shkoi në studion e skulptorëve. K. Rama, M. Dhrami, Sh. Hadëri i

pyeti ata se ku i kanë nxënësit se krijimtaria kolektive, aty ku është punuar me kujdes, ka dhënë rezultate. Që atëhere, me dy-tre grupe skulptorësh, kanë punuar edhe të rinj, por kjo eksperiencë duhet të shtrihet dhe të zhvillohet më tej.

Dalan Shaplo: PËR NJË KRITIKË TË DREJTË, TË KUPTUESHME DHE TË THELLË

Në fjalën e tij të 20 Dhjetorit 1974 shoku Enver bëri vërejtje serioze për kritikën tonë letrare dhe artistike, foli për dobësitë e saj dhe hapi horizont të ri, duke treguar se në ç'rrugë duhet të ecë ajo. Megjithë disa hapa përpara dhe një gjallërim pas Plenumit IV, kritika ka mbetur më prapa krijimtarisë artistike dhe na del detyrë të shtojmë përpjekjet tona për gjallërimin e saj të mëtejshëm që ajo të jetë realiste si veprat më të mira, që duhet të analizojë, e thjeshtë, pa fraza të ngarkuara dhe të tepërta, e kuptueshme dhe e kapshme nga lexuesit.

Kritika është një nga llojet e shkencës letrare, ajo që ndjek dukuritë aktuale, një gjini e gjallë dhe e shkathët, pa pasur ndofta atë peshë më të rëndë të historisë dhe të teorisë. Veçoria e kritikës përcakton edhe disa kërkesa. Gjuha e saj duhet të jetë e saktë, shkencore, mendimi të zëjë vend dhe të mos ketë frazeologji. Po kritika artistike ka të bëjë me artin dhe prandaj duhet të jetë e bukur (nuk është fjala për poetizime të kota), duhet të riprodhojë edhe emocionalisht veprën dhe të zgjojë dëshirë për ta lexuar ose parë e dëgjuar. Por nganjëherë kritika jonë është e thatë, vuan nga një akademizëm i pavend dhe vihen re stile të ngjashme, monotone. Janë të dëmshme, pra, si stilet «e lulëzuara» dhe pa bukë, ashtu edhe frazat e ngrira e standarte si dhe artikujt, që mbeten vetëm në përgjithësime tepër abstrakte, që nuk nisen nga studimi i veprës dhe nga procesi konkret artistik për të arritur në përgjithësime. Desha të shtroj edhe një çështje, që na ka shqetësuar edhe si shtyp letrar. Është e qartë se shkencat humanitare tek ne zhvillohen dhe njerëzit profilizohen në punën e tyre, po ne që merremi me studimin

e letërsisë e arteve jemi pak dhe ndihet nevoja, që edhe historiani i letërsisë apo i arteve të merret me kritikë, si edhe e kundërta (siç ka ndodhur). Ndarje me thikë nuk ka, dhe sot, me të drejtë, shtrohet çështja që duhet një punë më e madhe për të trajtuar problemet e aktualitetit, ku ndihen mungesa të shumta.

Që nuk ka ndarje të tilla, sidomos në kushtet tona sot, kjo duket edhe në pjesëmarrjen e shkrimtarëve dhe artistëve me fjalën e tyre në kritikë apo studime, gjë që ndihmon për gjallërimin e tyre, për një nerv të ri dhe sjell përvojën konkrete nga procesi i krijimit.

Problemi i analizës shkencore, profesionale dhe problemi i një stili të thjeshtë, të kuptueshëm, të dyja këto, nuk shkojnë në kundërshtim me njëra-tjetrën, po duhet të jenë në pajtim të plotë. Siç thuhet edhe në raport, profesionalizmi i sëmurë është i dëmshëm dhe nuk ka të bëjë me analizën e thellë profesionale. Gjithmonë kritika e thellë, serioze, përparimtare ka komunikuar me masën. Është kritika subjektivistike formaliste dhe hermetike ajo që qëndron larg masës dhe mbyllet në vetvete. Ta bësh veprën të kuptueshme, të zbërthesh qartë idetë e saj, ta bësh të dashur për masën (kur është me vlerë) — kjo kërkon aftësi. Subjektivizmi dhe paaftësia e kritikës lidhet pikërisht me shikimin e ngushtë brenda kopertinës së librit, notave, ngjyrave, pa gjetur kuptimin e gjërave dhe lidhjen e tyre me jetën dhe filozofinë. Është e qartë se brendia filozofike, sociale e veprës, siç pohonin klasikët e marksizëm-leninizmit, të cilët shoku Enver na mëson t'i studjojmë thellë, lidhet ngushtë me specifikën e artit, me gjuhën e tij të veçantë. Po këto, si edhe gjithë mjetet e shprehjes, duhet të studjohen në funksion të përmbajtjes dhe jo të bëhen qëllim në vetvete. Profesionalizmi i ngushtë, dashur pa dashur, të shpie në formalizëm dhe në një lloj aristokracizmi të kritikës, që shkruhet për një elitë, për një numër të kufizuar njerëzish. Ne tani kemi një numër shumë të madh njerëzish me kulturë, mijëra të rinj mbarojnë shkollat, dhe të mos kemi frikë se nuk na kuptojnë, po të dimë ta shpjegojmë mirë veprën, domethënien dhe specifikën e saj.

Një nga parullat kryesore estetizante të sotme në kritikë është ajo, që bën thirrje për largimin nga ideja, nga brendia sociale e veprës, e që përpiqet ta ngushtojë analizën vetëm brenda strukturës së veprës, duke e parë atë si një botë të mbyllur. Për këtë lloj kritike — gjuha,

fjalët, vendi i tyre në frazë, tingujt, ngjyrat, — janë gjithçka. Tjetra është sociologjizëm dhe anakronizëm. Prandaj, këto çështje, që shtrou shoku Enver për kritikën, nuk duhet t'i kuptojmë përciptazi, vetëm si të meta organizative apo të rritjes, po si probleme të thella ideologjike të luftës midis estetikës marksiste-leniniste dhe asaj idealiste, midis realizmit dhe formalizmit.

Analiza dhe interpretimi i drejtë social-estetik dhe filozofik i veprave kërkon nga kritika qëndrim objektiv dhe një vështrim dialektik të gjërave. Shoku Enver thotë: «Unë mendoj se një vepër e çdo gjinie qoftë, ka anët e mira dhe anët e saj të dobëta. Pikërisht për këtë është e nevojshme kritika, po jo kritika denigruese, e shtyrë nga ambicjet dhe ndjenjat e tjera të sëmura, por kritika e drejtë, objektive, konstruktive».

Për këtë është folur gjithmonë nga Partia dhe shoku Enver, p.sh., në Konferencën e 17-të të Tiranës, në Plenumin IV dhe në raste të tjera dhe ne jemi munduar të luftojmë subjektivizmin, megjithëse ka ende shfaqje dhe nuk mund të themi se lufta mbaroi. Kur zbulohen anët e mira apo të këqia të veprës duhet të gjendet çfarë është kryesore dhe atëhere kritika nuk mbetet eklektike, po bëhet dialektike. Ne kemi luftuar, me të drejtë, si kritikën panegjirike ashtu edhe atë që e sheh veprën me sy të errët, kur mungon dashamirësia. Por mendoj se ndodh që kritika nuk pranohet ose pranohet me shumë vështirësi dhe këtë duhet ta mbajnë parasysh edhe krijuesit, të cilët, nga natyra, janë të ndieshëm dhe shpesh preken kur u bëhet kritikë. Po është e qartë se sjell dëm ajo kritikë, e cila përpiqet kudo të gjejë të meta, edhe kur këto nuk janë themelore; sjell dëm kritika shkollareske, që thotë në fund disa të meta, sepse duhen thënë për të qenë «seriozë». Dashuria e kritikut ndaj veprave, autorëve është diçka, që duhet të shkojë krahas gjykimit objektiv. E vërteta nuk e përjashton pasionin, përkundrazi pasioni i drejtë, i ligjshëm, ndihmon për të zbuluar të vërtetën.

Praktika e sotme artistike ngre probleme teorike, që duan një sqarim të mëtejshëm nga studjuesit dhe kritikët tanë. Jo se nuk janë shkruar artikuj të tillë, por kur këto nuk nisen nga problemi konkret nëpër vepra, nuk mbështeten në analizë veprash, nuk ia arrijnë qëllimit sa duhet dhe mbeten në fuqi pështjellimet dhe keqkuptimet. P.sh., edhe më mirë duhet sqaruar, përmes analizës së veprave, problemi i tipikes, i së përgjithshmes dhe së veçantës në një vepër arti, se, duke i thjeshtëzuar këto

probleme ndodh që ne, botues, redaktorë, institucione teatrale etj. e kemi në majë të gjuhës përgjigjen: «kjo nuk botohet ose nuk shfaqet, se nuk është tipike». Kështu edhe për trajtimin e problemeve të kontradiktës, të zgjidhjes së saj, sidomos në drama, kërkohet një shpjegim i mëtejshëm teorik dhe, duke u nisur nga veprat, që i kanë më të theksuara këto anë, nga vështirësitë praktike, që kanë lindur dhe jo nga postulate abstrakte. Kështu dalin edhe mjaft probleme të tjera, që kërkojnë një zgjidhje të mëtejshme dhe rrahjen kolektive të mendimit.

E mbështetur në mësimet e Partisë dhe të shokut Enver, në estetikën marksiste-leniniste, në luftë kundër qëndrimeve estetizante, formaliste, kritika jonë ka për ta gjetur më mirë rrugën që të bëhet shprehëse e denjë e opinionit shoqëror dhe të ndihmojë më shumë në zhvillimin e kulturës sonë socialiste dhe të procesit letrar.

Pipi Mitrojorgji UDHËHEQJA E PARTISË — BURIM I GJITHË FITOREVE TË LETËRSISË DHE ARTEVE TONA

Udhëheqja e Partisë është burimi i sukseseve të letërsisë dhe arteve tona, është garancia e zhvillimit të tyre në rrugë të drejtë, në rrugën socialiste popullore, revolucionare. Parimin e partishmërisë proletare dhe të udhëheqjes së Partisë, të formuluar nga Lenini 70 vjet më parë, armiq të e të gjitha ngjyrave i kanë sulmuar parreshtur nga e majta dhe nga e djathta. Por këto parime kanë qëndruar të pamposhtshme dhe kanë dalë triumfuese. Udhëheqja e Partisë marksiste-leniniste dhe arti revolucionar proletar janë një e të pandarë. Mund të merret si aksiomë se pa udhëheqjen e Partisë marksiste-leniniste nuk ka letërsi socialiste revolucionare dhe as metodë të realizmit socialist.

Fronti ynë letraro-artistik është i vetëdijshëm për rolin dhe domosdoshmërinë e kësaj udhëheqjeje dhe lufton për ruajtjen, konsolidimin dhe perfeksionimin e vazhdueshëm të saj. Këtë vetëdije e kanë krijuar realiteti, zhvillimi i vrullshëm i letërsisë dhe arteve, eksperiencia e

gjatë e luftës klasore në këtë fushë në shkallë ndërkombëtare dhe kombëtare.

Udhëheqja e Partisë është, në radhë të parë, një udhëheqje ideologjike. Partia udhëheq revolucionin ideologjik e kultural, udhëheq edukimin e njeriut të ri me botëkuptimin marksist-leninist. Letërsia dhe artet, pjesë përbërëse dhe plotësuese e këtij revolucioni, mund ta kryejnë si duhet misionin e tyre të lartë edukativ shoqëror vetëm nën udhëheqjen ideologjike të Partisë. Kjo udhëheqje ideologjike synon gjithashtu armatosjen e gjithë artistëve me botëkuptimin revolucionar të proletariatit, me teorinë e njohjes dhe të zhvillimit, me teorinë e luftës së klasave, me vijën e Partisë sonë ku mishërohet kjo teori. Partia u jep kështu krijuesve busullën për t'u orientuar në rrugët e ndërlikuara të jetës. Këndej buron ajo detyrë e madhe për studimin sistematik të teorisë marksiste-leniniste në lidhje të ngushtë me përvojën revolucionare të Partisë sonë, me veprat e shokut Enver. Sa më të thella të jenë bindjet botëkuptimore marksiste-leniniste, aq më të pandura bëhen lidhjet e artistëve me Partinë.

Partia, me filozofinë e saj, me aftësitë e saj, me rolin dhe vendin, që zë në jetën e shoqërisë bën përgjithësimet të gjera ideologjike shkencore të fenomeneve letraro-artistike, bën lidhjen dialektike të tyre me fenomenet politike ekonomike, ideologjike, shoqërore, historike etj. Është Partia ajo që përpunon dhe pasuron vazhdimisht estetikën tonë marksiste-leniniste në teza e konkluzione të reja, të cilat kërkojnë një zbrëthim dhe konkretizim në praktikën krijuese. Fjala e shokut Enver e 20 dhjetorit 1974 është një shembull i madh i analizës dhe sintezës së fenomeneve letraro-artistike, i gërshetimit të tyre me fenomenet e jetës sonë. Prandaj, ky fjalim do studjuar për të përvetësuar sa më mirë idetë e tij estetike e për t'i zbatuar në praktikën krijuese.

Partia udhëheq tërë atë veprimtari politike shoqërore që realizon lidhjet e artistëve me jetën e popullit, aq jetike për procesin krijues. Partia nxit të çdo krijues inisiativën personale, prirjet individuale, fantazinë e shëndoshë, që buron nga perspektiva revolucionare. Ajo kujdeset për punën e çdo autori, përkrah veprat e mira e të dobishme, parandalon shkarjet ideologjike, nxit lidhjet e krijuesve me jetën, kultivon tek ata dëshirën e zjarrtë për t'i shërbyer me devotshmëri çështjes së popullit, socializmit e të revolucionit.

Vepra madhështore e Partisë, — ndërtimi i shoqërisë socialiste, ushtron një ndikim të fuqishëm mbi gjithë artistët. Këtë buron ai konkluzion i drejtë i tyre kur thonë: «Veprat tona ia detyrojmë Partisë, vijës së saj, udhëheqjes së saj, që krijoi këtë realitet madhështor prej të cilit buron frymëzimi ynë». Është e qartë se sa më shumë të zhyten artistët në jetën tonë socialiste, aq më tepër do të çelënikoset në mendjet dhe zemrat e tyre e vërteta e madhe se është vija e Partisë ajo që garanton, si në çdo fushë, zhvillimin e pandërprerë të krijimtarisë letraro-artistike.

Vetëm nën udhëheqjen e Partisë, nën prizmin e botëkuptimit të saj materialist dialektik mund të bëhet harmonizimi i parimit të partishmërisë proletare me frymën popullore kombëtare dhe me traditën e shëndoshë realiste. Këtë harmonizim e gjejmë në mënyrë të shkëlqyer e frymëzuese në fjalimet e shokut Enver për kulturën dhe artin, e gjejmë përsëri edhe në fjalën e tij të 20 dhjetorit 1974.

Partia është forcë e madhe novatore revolucionare. Prandaj vetëm nën udhëheqjen e saj, ashtu siç është vërtetuar nga tërë praktika jonë letrare, mund të ecë përpara në rrugë të drejtë procesi novator i letërsisë dhe arteve tona. Nën udhëheqjen e Partisë ne shpartalluam teorizimet pseudonovatore të Fadil Paçramit, Todi Lubonjës dhe gjithë pasuesve të tyre.

Letërsia dhe artet, si çdo fenomen shoqëror, i nënshtrohen luftës së klasave. Vetëm nën udhëheqjen e Partisë mund të zhvillohet me sukses lufta klasore në këtë fushë të ndërlikuar, delikate e shumë të ndieshme, mund të mbrohet letërsia dhe artet nga ndikimet formalist-moderniste, dekadente, borgjeze-revizioniste, dhe punonjësit e këtij fronti mund të vihen në pozita sulmuese kundër armiqve të socializmit dhe të artit të tyre. Dobësimi sadopak i udhëheqjes së Partisë çon në zbutjen e luftës së klasave, në inkurajimin e prirjeve liberale oportuniste me pasoja të rrezikshme për fatet e letërsisë dhe arteve tona. Edhe në fjalën e 20 dhjetorit shoku Enver na këshilloi përsëri të mos harrojmë luftën e klasave.

Udhëheqja e Partisë në këtë sektor është karakterizuar edhe nga kujdesi i gjithanshëm për talentet e reja. Partia na jep orientimin e drejtë për një konceptim dialektik të lidhjes së brezave dhe të eksperiencave të ndryshme të artistëve tanë. Me fjalimin e shokut Enver të 20 dhjetorit Partia na jep një platformë të gjerë sa pari-

more aq edhe konkrete për konsolidimin dhe harmonizimin e mëtejshëm të këtyre lidhjeve.

Të zbatojmë pra si gjithmonë me besnikëri, devotshmëri e konsequencë parimin e madh, frymëzues e mobilizues të udhëheqjes së Partisë sonë marksiste-leniniste mbi artin dhe letërsinë dhe ta mbrojmë atë nga çdo armik.

Dhimitër S. Shuteriqi JETË E GJALLË ARTISTIKE DHE LETRARE

Një nga arsyet që artet dhe letërsia jonë morën kaq shpejt për mbarë, qëndron, pa tjetër në besimin, që u frymëzoi atyre vazhdimisht Partia, duke çmuar përditë atë që ato kishin të re dhe hapin që ato bënin, edhe kur ky hap ishte ende modest. Fjala e shokut Enver Hoxha e 20 dhjetorit të vitit të kaluar mbi letërsinë dhe artet, le të na kujtojë edhe njëherë se me çfarë vëmendje shoku Enver dhe Partia i kanë përcjellë gjithmonë hapat e letërsisë dhe të arteve, janë gëzuar për sukseset e tyre, kanë vënë në dukje të metat e dobësitë.

Shkrimtarët e artistët përherë e kanë parë të ardhmen në ngjitje dhe këtë socializmi e ka shënuar pesëvjeçar mbas pesëvjeçari në Shqipëri, në mënyrë të vrullshme revolucionare, në tërë jetën e vendit. Po janë disa çaste, kur baza e krijuar lejon kërcime të reja, edhe më të mëdha se të mëparshmet. Më duket se përpara një gjendjeje të tillë jemi sot. Në shumicën e fushave të krijimtarisë letrare dhe artistike janë bërë grumbullime të rëndësishme, që lejojnë një hop të ri cilësor.

Le të shohim nivelin e përgjithshëm të letërsisë dhe të arteve tona. Ai është ngritur këto vjet, në mënyrë që të bën përshtypje. Është krijuar kështu një bazë më e gjerë e një nivel mesatar më i lartë, nga ku mund të bëhen kërcime të vërteta në të ardhmen. Pse u ngrit një bazë e shëndoshë dhe e një niveli të çmuar, patëm, ndër të tjera, sukseset që dihen të romanit, të muzikës instrumentale apo të skulpturës. «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» dhe «Kështjella», «Lumi i vdekur» dhe «Para agimit», «Qemal Stafa» dhe vepra të tjera të rëndësishme të prozës sonë, të krijuara në diçka më shumë ose më pak se një

dekadë, nuk u nisën nga një bazë e tillë e pasur dhe e gjerë si kjo, që kemi krijuar sot. Duke u nisur nga kjo bazë dhe nga arritjet e ndryshme të shquara veçanërisht, në pjesën më të madhe të gjinive, mundësitë e një hopi të shpejtë dhe për arritje të tjera të lakmueshme, janë të sigurta.

Ne kemi një sërë shkrimtarësh e artistësh me përvojë të pasur krijuese, me vepra të nivelit të lartë, që do të na nderonin kudo. Pastaj, gjeneratat e reja, që kanë ardhur e që po vinë, kanë lindur e po lindin me një përvojë të re dhe të përparuar të jetës socialiste dhe të artit socialist shqiptar. Pra, një vërsim temash e idesh, vërsimi i madh i jetës në art, e pret realizmin tonë socialist në tërësinë e vet.

Ajo, që nuk duhet lejuar nga shkrimtarët e artistët, të cilët, zakonisht, rrokin temat kardinale, është puna pa përgjegjësi, lëshimi i dorës, botimet pa vlera të vërteta, lëshimet gjoja në emër të përmbajtjes, e cila, kur nuk arrin të shprehet, ose kur shprehet keq, e pëson në vetvete, përmes formës së çkujdesur dhe lirive, që na qëllon të marrim me artin, dua të them liberalizimit, të qëndrimin tonë ndaj tij, si dhe përmes stereotipisë, që e ndrydh artin dhe krijon shabllonin. Pasuria jetësore, socializmi, pasuria e ideve dhe e ndjenjave, ideologjia e Partisë, nuk bëhen dot pronë e vërtetë e artit pa një punë shumë të kujdesur dhe plot përgjegjësi të secilit talent.

Kur flitet për një ndihmë konkrete, më të efektshme e më të vëmendshme ndaj veprave të të rinjve, më duket se do theksuar edhe ndihma reciproke, që duhet të ekzistojë midis brezave, që janë bërë tanimë të njohur në letërsi dhe arte. Ajo vëmendje e domosdoshme lë akoma për të dëshiruar. Kritika nuk dëgjohej ende sa duhet për krijimet dhe s'janë pak ato krijime, që i shpëtojnë syrit të kritikut. U botuan këto vjet e po botohen edhe më shumë romane, poezi etj. në seritë e veprave të zgjedhura. Ishte dhe është rasti për t'u rikthyer në njohjen e vlerësimitin e gjërave më të mira të autorëve, që ribotohen dhe të disa vlerave të shquara të krijimtarisë sonë të realizmit socialist. Është rasti për të njohur në një farë kompleksiteti përvojën tonë krijuese, përmes disa autorësh dhe në disa gjini. Kjo i shërben pasurimit tonë me përgjithësimin e asaj përvoje, kjo i shërben edhe gjallërimit të jetës letrare dhe artistike, kjo është edhe një detyrë ndaj artit e ndaj masave, që duan ta njohin më mirë atë, në zhvillimin e tij konkret dhe në arritjet më të çmuara të tij. Sigurisht,

kjo është punë së pari e kritikës profesioniste dhe e historisë së letërsisë. Po kritikët dhe historianët e letërsisë vështirë t'ia arrijnë. Ata janë pak dhe sasia e veprave u shumëzua mjaft. Veçse zëri i shkrimtarit për shkrimtarin, i piktorit për piktorin, i kompozitorit për kompozitorin, por edhe, — le të përzjehen, se është e këshillueshme dhe e domosdoshme, — zëri i kompozitorit për poetin, i romancierit për skulptorin, etj., ky zë vijon të dëgjohet pak e aspak. Shumica prej nesh mund të bënte autokritikë.

Tonin jetës letrare dhe artistike ia japin veprat, që korrin sukses në masa, por ia jep edhe ushëtima e veprës në kolektivin e krijuesve. Zëri i masave, i bashkuar me atë të kritikëve dhe të krijuesve vetë, ja ç'e bën të plotë jetën letrare dhe artistike, ja ç'e gjallëron, por edhe e shëndosh më shumë atë. Nuk është thjeshtësisht çështja te vlerësimi i punës, gjë e nevojshme për ta nxitur punën që të ecë përpara. Çështja është tek gjallërimi i vetë jetës së artit dhe të ambienteve artistike, ku të ziejnë interesat e shqetësimet për atë që sheh dritën, që, edhe kur nuk i ka cilësitë e larta, ka shpesh atë të renë, që lind përmes një teme dhe një motivi, që bën majë dhe është si ajo bimëza, e cila kërkon kujdes, — vështirimin, që e ngroh, vërejtjen, që e ndreq.

Ne kemi bërë përpara në këtë drejtim këto dy vjet, si në fushën e krijimtarisë, si në atë të kritikës, si në shëndoshjen e ambientit. Dënimi i punës armiqësore dhe anti-parti të F. Paçramit e T. Lubonjës, — për dëmin që kjo punë bëri në Lidhje, një përgjegjësi e rëndë bie edhe mbi mua, — solli rezultatet e pritura pozitive në gjithë jetën e arteve dhe të letërsisë. Kjo çelnikosi edhe më shumë artistin, që lufton për ta mbajtur sa më të pastër artin socialist, militantizmin në radhët tona, moralin antiindividualist, që ushqen socializmi dhe që e kultivon Partia te njerëzit. Ky është një fitim i madh për kolektivin e shkrimtarëve dhe të artistëve, kolektiv i pasur në talente dhe në virtute, dhe ky është një gëzim i madh për të gjithë ne. Porse ajo porosi, që jep shoku Enver, që Lidhja të mos burokratizohet, ajo i drejtohet secilit prej nesh për të mos u burokratizuar. Një jetë edhe më e gjallë artistike dhe letrare, jo vetëm përmes krijimtarisë, por edhe përmes një vëmendjeje më të madhe ndaj krijimtarisë, të një vëmendjeje më të çastit e më të përditshme, më duket se do zhvilluar akoma.

Shpëtim Kushta: T'I PROPAGANDOJMË MË SHUMË SUKSESET E MUZIKËS SONË

Partia, shoku Enver na këshillojnë ne (sidomos krijuesit e rinj) të njohim më shumë popullin. Dhe që ta njohësh më shumë popullin, do të thotë ta njohësh më thellë jetën. Natyrisht, njohja e jetës së popullit është një proces jo aq i thjeshtë, ka shumë anë dhe që të gjitha këto duhet të njihen prej nesh. Nuk mjafton vetëm të shkosh dy apo më shumë muaj në ndonjë zonë dhe kaq. Kjo është e nevojshme, por është e pamjaftueshme, mund të vesh atje dhe jetën mund të mos e njohësh. Mua më duket, se të njohësh jetën, do të thotë të njohësh njerëzit dhe pikësëpari të njohësh historinë e tyre. Historia jonë është plot luftra e drama të thella. Në këto luftra të vazhdueshme populli ynë ka qenë gjithmonë optimist, krenar, edhe në momentet më tragjike të jetës së vet ai ka ditur të shohë përpara, nuk e ka idealizuar jetën, por ka qenë gjithnjë realist. Ne duhet ta njohim për së afërmi këtë energji të madhe të popullit, të ushqehemi pikërisht me këto veti të çmuara të tij, me këtë dinamikë të fuqishme.

Një pjesë të jetës së tij shpirtërore populli e ka shprehur artistikisht me folklorin e tij. Në themel të këtij folklori muzikor ruhet një shije e hollë, e filtruar nga idealizmat dhe kjo pasuri është paraqitur me një bagazh të tërë mjetesh stilistike, që dallohen menjëherë, sepse janë krijuar nga një dorë mjeshtri.

Duhet njohur vazhdimisht dhe më thellë ky folklor origjinal që kemi.

Rrugët e asimilimit të tij janë të ndryshme, kjo është e natyrshme, por ka rëndësi një gjë, vepra jonë duhet ta ketë në thelb, në palcë, mendimin, filozofinë e popullit. Është një vërejtje shumë serioze ajo, që bën shoku Enver në fjalën e vet të 20 dhjetorit, kur thotë se nuk mjafton që vepra të ketë një akord apo një motiv dhe kaq, ajo duhet të jetë mbrytur me baltën e kësaj toke. Ky shpjegim shkencor ka rëndësi për një kuptim të drejtë të asimilimit të folklorit tonë. Që të bëhet drejt kjo, mendoj se ka rëndësi për ne kompozitorët që ta njohim krejt folklorin muzikor: monodinë, polifoninë, folklorin instrumental, vokal, vallet etj. Ne duhet, së pari, të njohim thellë poezinë e madhe të popullit në këto këngë, duhet

të njohim thellë mjetet e tij të fuqishme stilistike, që janë krejt origjinale. Populli me muzikën e tij flet shkurt, ai është i kursyer, i qartë, i thjeshtë, por nëpërmjet kësaj thjeshtësie ai ka krijuar figura të fuqishme muzikore.

Të gjitha këto vlera emocionale dhe stilistike në folklor duhen asimiluar prej nesh, po që të bëhet kjo, ne duhet të dimë të mendojmë, të ndiejmë ashtu thjesht, por thellë si populli, të krijojmë figura emocionale, me jetë larg idealizimeve, afër realitetit.

Por jetën e popullit, historinë e tij mund ta njohim dhe ta ndiejmë edhe duke mësuar nga veprat më të mira të krijuesve tanë me personazhe të fuqishëm. Është kjo një këshillë tjetër, që shoku Enver u jep krijuesve të rinj. Në veprat më të mira të tyre ka jetë, ka thellësi mendimi.

Në muzikë, edhe pse me pak traditë se letërsia, apo ndonjë art tjetër, megjithkëtë gjatë këtyre 30 vjetëve janë krijuar vepra të fuqishme realiste, vepra, që ruajnë vlera të thella kombëtare si baleti «Delina» e Ç. Zadesë, baleti «Halili dhe Hajrija» e T. Daisë, baleti «Cuca e maleve» e N. Zoraqit, koncerti për piano i F. Ibrahimit, i T. Harapit e plot vepra të tjera të Kozma Larës, Limoz Dizdarit, Kujtim Laros, etj. Pra, është krijuar një pasuri e tërë shpirtërore, e cila ushqen dhe edukon jo vetëm popullin, masat, por që duhet t'u shërbejë si model kompozitorëve të rinj.

Mendoj se vërejtja, që shoku Enver u bën poetëve të rinj, ku thotë se në krijimet e tyre duhet të ketë më shumë jetë, më shumë realizëm, u takon edhe kompozitorëve të rinj, prandaj studimi me seriozitet i veprave më të mira të muzikës sonë është një kërkesë e domosdoshme për ta.

Duke e parë krijimtarinë muzikore në lidhje të ngushtë me kërkesat e popullit e të Partisë, mendoj se para muzikës sonë në këtë stad të zhvillimit të saj dalin mjaft probleme: problemi i edukimit më të thellë me ideologjinë e Partisë, me estetikën marksiste-leniniste, njohja e jetës së popullit etj. Kjo e fundit varet nga ne vetë (sa do të jemi në gjendje të futemi thellë në mendimin e popullit), por varet edhe nga një punë më e organizuar, që duhet bërë nga shokët e Lidhjes. E vërteta është se kompozitorët lëvizin më pak se krijuesit e tjerë, nëpër veprat e mëdha apo të vogla të Atdheut.

Një nga problemet më të mprehtë është propagandimi i muzikës sonë. U bë konkursi i 30-vjetorit të Çlirimit, ku u paraqitën vepra me dinjitet dhe nuk u shkrua një

artikull, qoftë edhe i përgjithshëm. Pse të ndodhë kjo? Ne duhet të propagandojmë më shumë muzikën në popull, tek masat. Ne kemi vepra të fuqishme, sikurse kemi edhe individualitete të tillë, të cilët populli i çmon e do t'i çmojë më shumë, sepse janë artistë, që kanë dalë nga gjiri i tij dhe shprehin aspiratat e mëdha të kombit.

Anastas Kondo: MARKSIZËM-LENINIZMI DHE REALITETI YNË SOCIALIST JANË FRYMËZIM I MADH PËR SHKRIMTARËT DHE ARTISTËT TANË

Për ta bërë revolucionin e për ta çuar atë deri në fund, Partia na mëson se duhet njeriu i ri, i brumosur e i kalitur me botëkuptimin marksist-leninist, me ndërgjegjen e lartë komuniste. Dhe këtë njeri, që s'trembet e s'thyhet kurrë, këtë njeri, që çon përpara revolucionin, Partia po e kalit në kudhrën e madhe të luftës së klasave. Rolin fisnik e të fuqishëm të ndihmësit të saj, për formimin dhe edukimin komunist të këtij njeriu të ri, Partia, shoku Enver na e kanë besuar edhe ne shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë. Për këtë ne duhet të punojmë e të mendojmë ditë e natë, që me veprat dhe jetën tonë të jemi të denjë për këtë.

Vlerësimi i jashtëzakonshëm i punës sonë nga shoku Enver, nga Partia, është një frymëzim i madh, është një nder i madh për ne, të cilit duhet t'i përgjigjemi, sot e tutje, akoma më shumë me vepra sa më të mira e më të bukura.

Populli ynë gjithmonë ka ditur të qëndrojë e të këndojë burrërisht, me optimizëm e me besim në të ardhmen, në çdo shqotë e rrebesh të historisë së zhvillimit të tij, por veçanërisht sot ai është më i fortë se kurrë, se ka, siç thotë këngëtari popullor, «në ballë të karvanit Partinë, me yllin e saj Enver Hoxhën», ndaj është detyra jonë numër një, detyrë themelore e letërsisë dhe arteve tona t'i këndojë dhe të frymëzojë popullin, duke pasqyruar drejt e me dashuri veprën e tij të madhe, qëndresën e tij

heroike me Partinë në krye, për t'i bërë ballë e për të fituar mbi rrethimin e egër imperialisto-revizionist.

Për ne, shkrimtarët dhe artistët, përballimi dhe fitorja ndaj agresionit ideologjik e kulturor, ndaj rrethimit imperialisto-revizionist, është pjesë e përballimit të gjithë popullit dhe Partisë ndaj këtij agresioni. Dhe që të frymëzojmë popullin dhe të jemi të denjë për të në këtë luftë titanike, duhet që veprat tona, siç na mëson Partia, të përshkohen tejmbanë nga partishmëria e thellë proletare dhe të kapen e të mbërthehen fort, si stralli te mali, në tabanin popullor.

Partia jonë i vë shkrimtarët dhe artistët në piedestalin e lartë të njeriut të punës, krahas punëtorëve dhe fshatarëve, krahas atyre që krijojnë e prodhojnë të mirat materiale të shoqërisë. Nuk besoj se ka vlerësim më të madh për ne, shkrimtarët dhe artistët e vendit tonë, se sa ky. Dhe kjo presupozon e kërkon që, së pari e mbi të gjitha, këta punëtorë e fshatarë të jenë heronjtë kryesorë të veprave tona, që në krye të sofrës së madhe të letërsisë dhe arteve të jetë heroi i ri, pozitiv i ditëve tona heroike.

Pra, mbi të gjitha, për gjithçka thamë, është formimi dhe kalitja jonë ideologjike nëpërmjet veprave të Partisë, mësimëve të shokut Enver dhe jetës së gjallë të popullit, të jetuarit intensivisht, në mënyrë aktive, tok me popullin.

Talenti i shkrimtarit apo i artistit, mendoj, se i ngjan asaj lëndës kimike të domosdoshme, që duhet për formimin e mineraleve. Por si formimi i mineraleve ashtu dhe formimi i talentit ka dialektikën e vet të zhvillimit. Kristalizimi i mineraleve bëhet në temperaturë e thellësi të ndryshme të kores së tokës. Sa më thellë të jetë formuar, aq më e lartë është temperatura e kristalizimit, aq më i ndritshëm dhe më i fortë është talenti. Kështu, për shebull, dhe katrani, dhe qymyri i gurit linjit apo antracit ashtu dhe diamanti një përbërje kimike kanë karbonin, por ata janë aq të ndryshëm për nga vlera, fortësia, bukuria dhe përjetësia! Sepse janë formuar në thellësi e temperatura të ndryshme. Kështu, mendoj, se ndodh dhe me talentin e shkrimtarit dhe artistit. Sa më shumë të jetë futur shkrimtari dhe artisti në gjirin e popullit, në jetën e tij, sa më shumë të jetë ngrohur nga zemra e popullit dhe e Partisë, dhe nga ideologjia e Partisë, aq më i fuqishëm, më i ndritshëm, më i vlefshëm e më jetë-

gjatë bëhet talenti i tij, vepra e tij për popullin e vet. Kështuqë njohja e jetës së popullit nga afër, të jetuarit gju më gju me të gjithmonë, çdo ditë, çdo orë, është e domosdoshme për të gjithë ne shkrimtarët dhe artistët, si për më të afirmuarit e më të moshuarit, ashtu dhe ca më tepër për më të rinjtë nga ne. Se, në fund të fundit, ngritja e cilësisë së veprave tona, që ka të bëjë me dialektikën e jetës, ka dhe ajo dialektikën e saj. Se mund të ndodhë, dhe ka ndodhur, që një shkrimtar, që e ka njohur mirë jetën dje, vete fjala atë të fshatit, është shkëputur prej saj më vonë dhe sot talenti i tij është zbehur, është venitur, vepra e tij ka humbur vërtetësinë dhe bukurinë. Kjo është ca më shumë thelbësore për talentet e reja.

Po nuk bëjmë këtë lidhje, njohje me jetën e popullit, ahëre do të gënjejmë veten dhe të tjerët dhe do të fillojmë të trillojmë, t'i besojmë vetëm fantazisë sonë dhe atëhere me qind për qind bëhesh i pabesueshëm për lexuesin, dëgjuesin, spektatorin tënd, për popullin. Është vetëvrasje e vërtetë, katastrofë, për atë të zezë letërsi apo art, që i ndodh kjo. Dhe kjo ndodh, patjetër, kur nuk njeh jetën e popullit, kur ti dhe vepra jote bëheni të huaj për popullin, në fund të fundit, me ndërgjegje apo pa ndërgjegje, armik për të. Këtë kërkonin të realizonin me letërsinë dhe artet tona armiqtë e Partisë dhe të popullit Fadil Paçrami e Todi Lubonja. Këtë kanë dashur dhe duan gjithmonë armiqtë e realizmit socialist.

Problemin e lidhjes më të ngushtë me jetën nuk duhet ta kuptojmë sikur u përket vetëm shkrimtarëve dhe artistëve; mendoj se jo më pak u përket sidomos kritikëve dhe redaktorëve tanë. Që të mos bien në subjektivizëm në vlerësimin e veprave, që kritikojnë ose analizojnë, ata duhet ta njohin mirë e fort atë jetë, pasqyrimin e së cilës e gjejnë në veprat letrare e artistike.

Meqë procesi i njohjes së jetës për çdo shkrimtar e artist është një domosdoshmëri dhe që nuk ka fund kurrë, mendoj se, krahas aksioneve që mendohet të ndërmerren nga organizata jonë, duhet që shokët tanë shkrimtarë dhe artistë në profesion të lirë të lidhen drejtpërdrejt me qendra pune e prodhimi, me ndërmarrjet, kooperativat, repartet tona ushtarake. Mendoni se sa i madh do ishte në këtë rast përfitimi i tyre në procesin e njohjes së jetës dhe veprat e tyre, patjetër, do të ngriheshin më lart për sa i përket pasqyrimin me vërtetësi të kësaj jete. Nuk mendoj

që kjo lidhje të jetë e «përjetshme» me këtë apo atë ndërmarrje, por, të paktën, për një ose dy vjet apo më shumë, si t'i vlejë më mirë shkrimtarit apo artistit për temën, që do të realizojë. Mendoj se kështu mënjanojmë dhe rrezikun e burokratizimit të shkrimtarëve apo artistëve tanë, se ky rrezik në punën tonë del në pah tërësisht në shkëputjen tonë nga populli, nga jeta e gjallë e tij. Nuk them se kjo është mënyra e vetme për t'u lidhur me jetën, se kjo lidhje është shumë e gjerë dhe nuk njeh receta, por sidoqoftë, është një nga mënyrat praktike për të marrë pjesë në gëzimet, hallet, problemet e punës dhe të jetës së njerëzve tanë. Është një mundësi e madhe për shkrimtarin apo artistin në profesion të lirë, për të mbajtur një qëndrim aktiv e jo soditës. Si shembull i mirë në këtë drejtim, por që ka nevojë të thellohet, mund të vlejë lidhja, që mban Jakov Xoxa me Ballshin apo Dhimitër Xhuvani me Kombinatin Metalurgjik në Elbasan. Një mungesë e gadishmërisë për këtë formë lidhjeje me jetën do të ishte një qëndrim intelektualist ndaj jetës sonë, ndaj njerëzve tanë të punës.

Për talentet e reja, për shokët tanë më të rinj, krahas asaj themelores — kalitjes dhe formimit të vërtetë ideopolitik me veprat e Partisë dhe të shokut Enver dhe njohjes aktive të jetës e krijimtarisë letraro-artistike më të mirë, një ndihmë reale, e kapshme dhe frutdhënëse do të ishte dhe krijimi e marrja në patronazh e rrethëve letraro-artistike të ndryshme, ose dhe kujdesi për çdo të ri të talentuar të veçantë nga më të moshuarit prej nesh.

Duke parë se çështja e repertorit të teatrove tona është problemi kryesor i tyre sot, dhe kur shumë drejtues të këtyre teatrove duket se presin drama «të rëna nga qielli», kur ndodh që një dramë, që e konsideron të pavlefshme njëri teatër, tjetri e vë në skenë dhe spektatori e mirëpret, mendoj në këto kushte aktuale që jemi, repertori nuk duhet të vazhdojë të zgjidhet vetëm duke u lënë në dorën e teatrove të veçanta si sot, pra të zgjidhet me një farë spontaniteti: «na pruri dramaturgu dramë, mirë! S'na pruri gjë, s'kemi ç'të bëjmë!». Mendoj që kjo zgjidhje të bëhet duke u centralizuar nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, që të mos sorollaten autorët lart e poshtë në kërkim të aprovimit të dramave të tyre nga teatrot e veçanta. Pra, të ketë, krahas atij, që do sigurojnë vetë teatrot nga dramaturgët. dhe një pjesë repertori të

sugjeruar nga vetë ministria, se kam përshtypjen që teatrot tona tregohen shumë qibarë ndaj dramave tona, se në fakt drama në sasi shkruhen (vërtet ende të pakta në cilësi), por nuk është e drejtë që për këtë teatrot të mos vënë hiç premiera të reja.

Një punë më të madhe me talentet e reja mendoj se duhet të bëjnë, krahas Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, dhe organizatat e rinisë dhe aparati i KQ të BRPSH. Se fidanishtja e madhe e talenteve të reja ka nevojë për djersën dhe dashurinë e të gjithë neve.

VLERESIM DHE INKURAJIM I MADH

- Punonjës të tjerë të artit
nderohen me titujt e lartë
"Artist i popullit,, dhe "Artist i merituar,,

Në një atmosferë të gëzueshme dhe revolucionare, më 5 mars, u organizua në Pallatin e Kulturës të Tiranës një mbledhje e gjerë për shpalljen e titujve «Artist i Popullit» dhe «Artist i merituar», akorduar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor disa punonjësve të artit.

Në këtë mbledhje merrnin pjesë artistë të teatrove dramatike, teatrove të estradave, Teatrit të Operas dhe Baletit, kinematografisë, Cirkut, shkrimtarë, piktorë, skulptorë, punonjës të institucioneve kulturore e artistike, përfaqësues të organizatave të masave etj.

Ishin të pranishëm gjithashtu anëtarë të Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të Partisë Ramiz Alia, zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave Xhafer Spahiu dhe shokë të tjerë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë Dritëro Agolli.

Ministri i Arsimit dhe Kulturës Thoma Deliana, që përshëndeti në emër të Presidiumit të Kuvendit Popullor në ceremoninë e dorëzimit të titujve të lartë «Artist i Popullit» dhe «Artist i merituar», vuri në dukje kontributin e madh, që japin artistët e vendit tonë si ndihmës të Partisë për edukimin komunist të masave punonjëse. Duke folur për nderin dhe vlerësimin e madh, që iu bëhet një numri përfaqësuesish të shquar të artit dhe të kulturës sonë, ndërmjet të tjerash, ai tha: «Kjo është një shprehje tjetër e kujdesit, vlerësimit dhe inkurajimit të

madh, që populli, Partia dhe pushteti ynë u bëjnë artistëve e shkrimtarëve për punën e tyre, për veprat e tyre, për kontributin e rëndësishëm, që ata japin për çështjen e revolucionit e të socializmit».

Në emër të Presidiumit të Kuvendit Popullor, shoku Thoma Deliana shpalli pastaj punonjësit e artit, të cilëve iu dhanë titujt e lartë «Artist i Popullit» dhe «Artist i merituar».

Titulli «Artist i Popullit» iu dha artistëve:

Avni Mula, Athanas (Tano) Banushi, Çesk Zadeja, Kristaq Antoniu, Marije Logoreci, Melpomeni Çobani, Nikolin Xhoja, Pandi Raidhi, Telat Agolli.

Titulli «Artist i merituar» iu dha artistëve:

Albert Janku, Behije Lëvonja, Dhimitra Mele, Enver Dauti, Enver Birko, Ganimet Vendresha, Gjoni Athanas, Lefka Mullisi, Naile Hoxha, Nadire Lubonja, Nina Mula, Petrit Vorpsi, Pina Shkurti, Pranvera Uruni, Prokop Mima, Spiro Strati, Xhevdet Hafizi.

Titulli «Piktor i merituar» iu dha piktorit: Agim Zajmi.

Me urdhërin «Naim Frashëri të klasit të parë» u dekorua: Muzeumi i Luftës Nacionalçlirimtare të Tiranës.

Urdhëra e medalje iu dhanë edhe disa punonjësve të Muzeumeve të Tiranës.

Artistët Çesk Zadeja, Avni Mula, Pandi Raidhi, Prokop Mima dhe Telat Agolli falenderuan për nderin dhe vlerësimin e madh, që iu bë nga Partia dhe shprehën gati-shmërinë se do të punojnë pa u lodhur dhe do të venë të gjitha forcat për t'i dhënë popullit gjithnjë e më shumë vepra të denja të realizmit socialist.




Foto Stamo:
Në shërbim.

KRIJIME LETRARE

Maro Pasho

Ç'MË THA KËNGËTARJA POPULLORE NGA PILURI

Nëna ime kishte zë të bukur,
Nëna ime kishte zë të ëmbël,
Mund të shkrinte bora
përmbi degët e pishave
po të këndonte
nëna ime.

Mund të çelte vjollca
mes ferrash,
po të këndonte
nëna ime.

Mund të ndalonin varkat në breg,
po të këndonte
nëna ime.
Po ajo ia mirrte rrallë këngës...
E ndrydhte zërin
brenda vetvetes
me pllakën e rëndë të zisë.
Ç'duar do ta lëviznin vallë
atë pllakë zije,
që i merrte frymën
nënës sime?